

85/32

11.10.2021




AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Financë Bankë”
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i
Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Artur RIBAJ 

2. Prof. As. Rezarta SHKURTI PERRI 

Tetor/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Financë Bankë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”.

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë Bankë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMSH Nr. 482, datë 03.10.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr.6/1, datë 19.05.2017
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMSH Nr. 358, datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.70 datë 28.09.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/4 PAK v.a 2020-2021 7 PAE/5 PAK v.a 2019-2020 5 PAE/8 PAK v.a 2018-2019
18	Numri i studentëve:	159 Studentë v.a 2020-2021 257 Studentë v.a 2019-2020 249 Studentë v.a 2018-2019
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 2

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është një program studimi i hapur në vitin 2011 nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Programi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 482, datë 03.10.2011 dhe akreditohet për herë të parë në vitin 2012, bazuar në Urdhërin 291 datë 11.07.2012 si dhe VKA 334, dt. 08.06.2012. Ky program është riakredituar në vitin 2018 me Urdhër të Këshillit të Akreditimit me VBA Nr.70 datë 28.09.2018.

Programi i studimit “Master i Shkencave në Financë Bankë”, është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Programi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në module, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit, gjithsej 120 ECTS i ndarë në dy vite akademike dhe katër semestra.

Objektivi kryesor i këtij programi është t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e biznesit dhe shkencave ekonomike. Programi synon të formojë menaxherë dhe specialistë të mirëfilltë në fushën e menaxhimit financiar të shoqërive dhe organizatave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Të regjistruar në vitin 2018-2019 ishin 233 studentë; në vitin 2019-2020 ishin 248 studentë; dhe në vitin 2020-2021 ishin 155 studentë.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Referuar përmbushjes së rekomandimeve në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.70, datë 28.09.2018, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Financë bankë", të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", vlerësimi paraqitet si vijon:

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik me kohë të plotë, me grada dhe tituj, për mbulimin e ngarkesës mësimore të paktën në nivelin 70 %, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Referuar Evidencave të paraqitura në DVV, si edhe argumentave të paraqitura, ky rekomandim është i përmbushur plotësisht nga Institucioni. Në vitin e fundit akademik 2020 - 2021, nga 14 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 4 janë PAK dhe 10 PAE duke qëndruar në raportet 29 % / 71 %. Përsa i përket ngarkesës akademike që ata mbulojnë nga 1.245 orë totale për programin e studimit për vitin akademik 2020 - 2021, 345 orë realizohen nga PAK dhe 900 orë realizohen nga PAE duke dhënë një raport 28 % / 72% përkatësisht PAK / PAE.

2. Institucioni, të rishikojë dhe përditësojë syllabuset, duke reflektuar në to ndryshimet e shpejta në këtë fushë.

Referuar evidencave të paraqitura, Institucioni është përpjekur të përditësojë syllabuset, gjithmonë brenda normave që lejon ligji për programet e studimit. Pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme, ka vënd për përmirësime të cilat mund të ndërmerren sidomos në drejtim të përditësimit të literaturës së përdorur dhe lëndëve më të profilizuara për këtë program Studimi.

3. Institucioni, të marrë masa të menjëhershme për pasurimin e bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, në funksion e mbulim të plotë të lëndëve të këtij programi studimi.


Referuar evidencave dhe verifikimit në Bibilotekë, Institucioni është përpjekur të përditësojë titujt në dispozicion të studentëve të këtij programi Studimi, por ende ka vënd për përmirësime .

4. Institucioni, të realizojë një studim të mirëfilltë tregu, ku të evidentohen kërkesat reale të tregut për studentët e diplomuar në këtë fushë, dhe përkundrejt shkallës dhe cilësisë së punësimit të brezave të studentëve të saj.

Referuar dokumentave të paraqitura në DVV nuk ka evidencë të mjaftueshme që ky rekomandim është i përmbushur. Analiza e pretenduar nga Institucioni nuk fokusohet në mënyrë të vecantë në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, dhe çfarë mungon në këtë studim janë të dhënat nga komunikimi me punëdhënësit e sektorit financiar dhe bankar, nevojat dhe kërkesat e tyre për aftësitë dhe kompetencat që studentët duhet të kenë në përfundim të studimeve dhe mundësitë e punësimit të studentëve.

5. Në procesin e shtimit e përmirësimit të stafit, të mbahet parasysh dhe ndarja e detyrave akademike nga ato administrative dhe kualifikimi i stafit ndihmës-mësimor e sekretarisë mësimore.

Referuar evidencave të paraqitura, por më tepër edhe intervistave të kryera nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, vlerësojmë se duhet bërë një punë më e mirë në këtë drejtim. Ende një pjesë e mirë e stafit akademik janë të ngarkuar me detyra të tjera administrative.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Mbështetur në VKM nr. 109 ASCAL ka percaktuar kohen dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm me Urdher nr. 85/8, dt. 08/06/2021, për akreditimin e programit Master Shkencor në “Financë Bankë”. Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Dr. Artur Ribaj;
2. Prof. Asoc. Dr. Rezarta Shkurti Perri;
3. Msc. Muhamed Prezja, Koordinator teknik i ASCAL.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ky dokumentacion pati disa mangësi të cilat u kërkuar të plotësohen nga ekspertët para se ata të shkonin për vizitë.

Ekspertët përgatitën draft vlerësimin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 1-2 Korrik, 2021. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrative, etj. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 05 Korrik, 2021 përmes sistemit të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave dhe komenteve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Shkencor në “Financë Bankë”. Në fund do të paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi rekomandimin nr. 3: **Institucioni, të marrë masa të menjëhershme për pasurimin e bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, në funksion e mbulim të plotë të lëndëve të këtij programi studimi.**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë ka një rishikim të të shprehurit të qëndrimit, megjithatë ende ka vend për përmirësim.

2. Për komentin e IAL mbi rekomandimin nr. 4: **Institucioni, të realizojë një studim të mirëfilltë tregu, ku të evidentohen kërkesat reale të tregut për studentët e diplomuar në këtë fushë, dhe përkundrejt shkallës dhe cilësisë së punësimit të brezave të studentëve të saj.**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse GVJ i referohet studimit të tregut i cili ofrohet si evidencë nga Institucioni. Dhe në këtë studim të tregut nuk vendoset në fokus programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë.

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.3 Kriteri 1,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse GVJ i referohet Rregullores së Programit të studimit dhe jo syllabuseve të lëndëve. Fakti që në syllabuset e lëndëve jepen me shumë detaje rezultatet e pritshme të ët nxënit nuk kompenson nevojën që më së pari, kompetencat profesionale që pritet të fitojnë studentët të jenë të specifikuara qartë dhe në mënyrë jo të përgjithshme, por specifike në Rregulloren e Programit të studimit.

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.3 Kriteri 7,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse thelbi i sugjerimit të GVJ në këtë kriter nuk janë lëndët e përmendura por mësimdhënia në gjuhë të huaj, ndoshta në këto lëndë, ose në lëndë të tjera. Aktualisht asnjë prej këtyre lëndëve nuk ofrohet në gjuhë të huaj, ndaj edhe jepet kjo këshillë nga ana e GVJ. Kujtojmë që sugjerimet dhe këshillat e GVJ kanë në fokus përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe ky është një opinion i cili mesa duket do të zbatohet në të ardhmen nga ana e Institucionit.

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.1 Kriteri 3 dhe 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse ky është opinionin i anëtarëve të GVJ bazuar në çfarë shohin në Planin Mësimor dhe programet lëndore.

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.1 Kriteri 5,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë NDRYSHON nga: „Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten kryesisht në përputhje me aktet ligjore....“ në: „Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten plotësisht në përputhje me aktet ligjore.....“ (paragrafi 2, Standardi II.1, kriteri 5.

Vlerësimi total për këtë kriter NUK ndryshon.

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.2 Kriteri 5,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse sugjerimi i dhënë në këtë pikë nga GVJ lidhet me Personelin Ndihmës Akademik sic kërkohet në kriterin dhe standardin përkatës.

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.3 Kriteri 5,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse ky është një opinion i anëtarëve të GVJ për të përmirësuar cilësinë e elementëve të programit të studimit.

9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.4 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse këtu referohet çfarë u transmetua si nevojë e perceptuar nga ana e studentëve të programit. Argumenti i Institucionit se programi kompjuterik Financa 5, është pjesë e studimeve të nivelit bachelor në UMSH nuk përmbush mangësitë që mund të kenë studentë të cilët në programin e studimit MscFB vijnë nga Institucione të tjera.

10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.1 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse konstatimi i dhënë në këtë pikë nga GVJ nuk rezulton i plotësuar siç kërkohet në kriterin dhe standardin përkatës.

11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse GVJ ka bindjen se është në përfitimin e studentëve që Institucioni të shtojë hapësirat e bibliotekës dhe postet kompjuterike në dispozicion. Në RVB vazhdimisht citohen tre biblioteka të Institucionit, por GVJ konstatoi vetëm një të tillë.

12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 1 dhe 2,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse GVJ shprehet këtu në lidhje me atë çfarë i kërkohet nga kriteri përkatës. Kriteri kërkon hartimin e raportit financiar të programit të studimit, i cili nuk është përgatitur nga Institucioni, dhe GVJ duhet ta referojë këtë fakt. Institucioni deklaron në komentet e tij se është gati ta japë këtë informacion, por kjo as nuk u siguroa në RVB dhe as më vonë kur u përmend gjatë takimit në Institucion. Në këtë pikë të vlerësimit, nuk ka vlerë sigurimi i informacioneve shtesë.

13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi pavarësisht se Institucionit iu kërkua të jepte të dhëna, nuk i vuri ato në dispozicion në momentin e specifikuar. Theksojmë se të dhënat në lidhje me Pasqyrat Financiare të Audituar janë më ligj, publike dhe nuk çenohet asnjë kusht konfidencialiteti në kërkimin e tyre nga ana e GVJ. Në këtë pikë të vlerësimit nuk ka vlerë sigurimi i informacioneve shtesë, pasi GVJ e ka formuar opinionin e saj.

14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.5 Kriteri 2,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse konstatimi i dhënë në këtë pikë nga GVJ nuk rezulton i plotësuar siç kërkohet në kriterin dhe standardin përkatës. Për më tepër referojuni RVJ në paragrafet respektive.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 8

15. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.1 Kriteri 1,2,3 dhe 4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse konstatimet e dhëna në këto pika nga GVJ nuk rezultojnë të plotwsuara siç kërkohen në kriteret dhe standardet përkatëse. Për më tepër referojuni RVJ në paragrafet respektive dhe mirëkuptoni sugjerimet e dhëna me qëllim vijimin e përmirësimit të cilësisë për këtë program studimi.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i “Shkencave në Financë Bankë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE.

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, UMSH, është Institucion i Arsimit të Lartë që ofron programe studimi në fushat <i>ekonomike, juridike sociale dhe politike</i> , fusha të cilat janë me interes për zhvillimin dhe përparimin e Shqipërisë. Sipas Statutit të UMSH, neni 4, pika 1 (evidenca 1 në Dosjen e Vetë Vlerësimit, DVV), vizioni i Institucionit është: “krijimi i një institucioni cilësor të arsimit të lartë, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi; nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë qytetarë të angazhuar dhe me integritet në një medis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare”. Për më tepër një ndër pikat e misionit të institucionit (Evidenca 1, neni 4, pika 2, paragrafi 5) thekson se Institucioni ka si mision “të kontribuojë në mbështetjen e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”. Bazuar në këto dy elemente, Institucioni e përmbush kriterin e kërkuar. (Evidenca 1 “Statuti i UMSH”.)
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Misioni i Universitetit (Evidenca 1, neni 4, pika 2), përfshin disa elemente si: „ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në shkencat ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë”; “zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit”; “formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike nëpërmjet programeve universitare të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik”; “thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë duke ofruar mundësi të mira për të përfutur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”; “të kontribuojë në mbështetjen e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Qëllime të UMSH (Statuti i UMSH, neni 5, pika 1), janë ofrimi i studimeve universitare në cikle të ndryshme dhe mësimi gjatë gjithë jetës.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10

	<p>UMSH angazhohet në promovimin, organizimin dhe realizimin e shërbimeve kulturore e formuese kombëtare (Statuti i UMSH, neni 5, pika 3) të cilat konservojnë vlerat shqiptare në këto fusha. Instrumente për arritjen e misionit të institucionit (evidenca 6, faqja 8) janë ndër të tjera edhe arritja e ekselencës në fushën akademike dhe ndërtimi i urave të bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal duke demonstruar qëllimin e ruajtjes së vlerave të krjuara në shoqërinë tonë.</p> <p>Konkretisht, programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është konceptuar si mjet për realizimin e më shumë se një pike të misionit të plotë të institucionit, dhe vjen në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p>Në evidencën 7, pika 2, parashtrahet edhe qëllimi i aftësisht të studentëve në fushën e financës dhe bankës dhe bashkëpunimi me bizneset vendase duke demonstruar kështu prioritetin e programit për specifikat akademike vendase. UMSH gjithashtu angazhohet të lidhë marrëveshje me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike, kërkimi e të konsulencës (Statuti i UMSH, neni 5 pika 2) duke treguar kështu vullnet të mirë për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH"; Evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH"; Evidenca 7 "Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Financë Bankë")</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Në evidencën 7, pika 2, ndërkohë që zërthehet misioni i programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, parashtrahet edhe qëllimi i ngritjes së specialistëve të aftë në fushën e financës dhe bankës duke u ofruar atyre njohuri akademike dhe aftësi kërkimore.</p> <p><i>(Evidenca 7 "Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Financë Bankë")</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të</p>	<p>GVJ shqyrtoi në mënyrë të detajuar dhe të krahasuar Planin Strategjik të zhvillimit të UMSH, 2018 - 2023 dhe Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor në Financë Bankë 2017 – 2021. Plani</p>

<p>strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>strategjik i UMSH, ose ndryshe Strategjia e Mësimdhënies, Dijeve të Qëndrueshme, Bashkëpunimit dhe Kërkimit Shkencor, (MDBK) është hartuar me qëllimin e përmirësimit të mësimdhënies (evidenca 6), dhe përvetësimin e dijeve në nivel shkencor dhe pasqyron vizionin e UMSH për politikën afatmesme dhe afatgjatë në katër aspektet e strategjisë. Në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit specifikohen qartë misioni (përgatitja e specialistëve në fushën e financës), qëllimi (formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfillitë në fushën e financës bankës), dhe objektivat (vijimi i konsolidimit dhe zotërimit të njohurive të përfuara në ciklet e mëparshme të studimit). GVJ gjykon se dy dokumentat tregojnë përputhshmëri në fokusin, dhe shtrirjen e trajtimit të këtyre elementeve.</p> <p><i>(Evidenca 6 “Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH” Evidenca 7 “Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Financë Bankë”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UMSH si një nga dokumentat bazë të rregullimit të funksionimit të Institucionit është i qartë në identifikimin e drejtimeve prioritar akademike të tij: “ofrimi i arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në shkencat <u>ekonomike, juridike, marrëdhënies ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike</u> që realizojnë synimet e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë” (Evidenca 1, neni 4, pika 2). Në përputhje me këto drejtime prioritar akademike, në Rregulloren e Institucionit (Evidenca 2, neni 10, pika 3), përcaktohet edhe organizimi i UMSH në tre fakultete të cilat përkohet me një mbulim tërësor të këtyre drejtimeve: Fakulteti i Shkencave Ekonomike; Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare; Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është konceptuar si pjesë e ofertës akademike në drejtimin ekonomik dhe është organizuar e strukturuar në mënyrë të tillë që të përmbajë njohuri për përmbushjen e një prej drejtimeve prioritar, atë ekonomike (Evidenca 6).</p> <p><i>(Evidenca 1 “Statuti i UMSH”; Evidenca 2 “Rregullore e Organizimit të UMSH”; Evidenca 6 “Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të nevojshëm, pjesë e DVV, GVJ mund të konstatoj se programi i studimit është hartuar duke pasur parasysh përfaqshen me elementë të strategjisë dhe politikës kombëtare të zhvillimit në aspektin ekonomik dhe financiar. Synimi i programit për të përgatitur specialistë dhe ekspertë në fushën e financës bankës, jo vetëm për tregun vendas por edhe atë ndërkombëtar (evidenca 7) ka përputhje me interesat kombëtare të fuqizimit të sektorit financiar e bankar të Shqipërisë, si edhe zë vend në kontekstin global të rëndësisë që sektori financiar ka në avancimin ekonomik të tregjeve botërore.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të nevojshëm, pjesë e DVV, GVJ mund të konstatoj se programi i studimit është hartuar duke pasur parasysh përfaqshen me elementë të strategjisë dhe politikës kombëtare të zhvillimit në aspektin ekonomik dhe financiar. Synimi i programit për të përgatitur specialistë dhe ekspertë në fushën e financës bankës, jo vetëm për tregun vendas por edhe atë ndërkombëtar (evidenca 7) ka përputhje me interesat kombëtare të fuqizimit të sektorit financiar e bankar të Shqipërisë, si edhe zë vend në kontekstin global të rëndësisë që sektori financiar ka në avancimin ekonomik të tregjeve botërore.</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 12

	<i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH"; Evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH"; Evidenca 7 "Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Financë Bankë".)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niv. përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit specifikohen qartë misioni (përgatitja e specialistëve në fushën e financës), qëllimi (formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e financë bankës), dhe objektivat (vijimi i konsolidimit dhe zotërimit të njohurive të përftuara në ciklet e mëparshme të studimit) e këtij programi studimi i cili përkon me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Nga ana tjetër, GVJ shqyrtoi edhe Rregulloren e programit të studimit (evidenca 5) ku në nenin 4 të tij listohen objektivat formuese: (1) formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e financave, bankave, sigurimeve, etj; (2) formimi teorik dhe praktik i studentëve në fushat e drejtimit të kontabilitetit, menaxhimit financiar, menaxhimit dhe teknikave bankare; (3) thellimi i njohurive shkencore në fushën e financave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për të aftësuar studentët të ndjekin zhvillimet bashkëkohore.</p> <p>GVJ gjykon se në Rregulloren e Programit të Studimit një punë më e mirë mund të bëhet në drejtim të detajimit të kompetencave profesionale që duhet të fitojnë studentët deri në përfundim të programit të studimit, pasi aktualisht jepen vetëm objektiva formuese të cilat janë shumë të përgjithshme.</p> <p><i>(Evidenca 5 "Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Financë Bankë". Evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH")</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga</p>	<p>Në prill të 2021, Institucioni ka kryer një studim të tregut të punës për programet e studimit që ofron (evidenca 16). GVJ është e mendimit se kjo analizë bazohet në të dhëna nga oferta</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 13

<p>komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>akademike, sipas klasifikimi të ISCED dhe të dhëna në nivel kombëtar të shoqëruara me interpretime.</p> <p>Por, evidentojmë se kjo analizë nuk fokusohet në mënyrë të vecantë në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, por në tërësi për programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike. Kësisoj, çfarë mungon në këtë analizë janë të dhënat nga komunikimi me punëdhënësit e sektorit financiar dhe bankar, nevojat dhe kërkesat e tyre për aftësitë dhe kompetencat që studentët duhet të kenë në përfundim të studimeve dhe mundësitë e punësimit të studentëve.</p> <p>Po kështu, referenca tjetër e ofruar në RVB për këtë kriter, (evidenca 18, tabela 23), nuk jep informacionin e detajuar që kërkon ky kriter dhe as nuk gjejmë zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> <p>GVJ këshillon kryerjen e analizës së tregut të punës me fokus specifik në këtë program studimi, dhe me të dhëna që vijnë drejtpërdrejt nga kontaktet me pretendentët dhe në veçanti me punëdhënësit, nevojat që ata kanë dhe sugjerimet që ata japin.</p> <p><i>(Evidenca 16 “Analiza e Tregut të Punës”. Evidenca 18 “Tabelat e RVB – Tabela 23”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitim dhe dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Komponentët e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, si objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit, rezultatet e të nxëniet, sic u përmend edhe më lart, janë informacione që gjenden në nivel shumë të përmbledhur në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>GVJ mori informacion për shpërndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese (A-E sipas kërkesave të VKM 41 të ndryshuar), edhe nga tabelat informuese të RVB (evidenca 18), ku paraqitet një shpërndarje e lëndëve mes aktiviteteve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, plotsuese dhe detyrime përmblyëse).</p> <p>Në mënyrë më të detajuar, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe konceptet themelore të programit i gjejmë në syllabuset përkatëse të lëndëve në planin mësimor (evidenca 13). GVJ gjykon se këta komponentë garantojnë kryesisht përfitim dhe aftësive, zotësive dhe kompetencave të nevojshme nga ana e studentëve për t’iu përgjigjur zhvillimeve dhe kërkesave të tregut të punës.</p> <p><i>(Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Financë Bankë”. Evidenca 13 “Programi</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 14

	<i>Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma” Evidenca 18 “Tabela 9 – Plani Mësimor sipas aktiviteteve formuese”.)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	UMSH dëshmon një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të huaja, (evidenca 19) çka lehtëson përthithjen dhe implementimin e modeleve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Vec kësaj, Institucioni ka miratuar dhe implementuar në vitin 2017 një strategji për Institucionalizimin e tij (evidenca 8), ku një ndër synimet strategjike është edhe mbështetja e lëvizjes ndërkombëtare të studentëve. <i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”. Evidenca 8 “Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH”. Evidenca 19 “Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera”.)</i>
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disa vjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	Referuar dokumentacionit të DVV, programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë paraqitet i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin tonë, si Ligji për Arsimin e Lartë dhe Korniza Shqiptare e Kualifikimeve; si edhe në përputhje me orientimet e BE-së për arsimin e lartë si Karta e Bolonjës dhe Sistemi European i Krediteve. <i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”.)</i>
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Një ndër objektivat formuese të programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë (evidenca 5) ishte aftësimi i profesionistëve në financë dhe institucione bankare. Plani mësimor i programit të studimit ka parashikuar 12 ECTS praktikë profesionale (evidenca 13), që do të thotë 7 javë praktikë ose rreth 300 orë (evidenca 39, pika 7). Në vitin 2019, Institucioni ka hartuar një udhëzues në lidhje me praktikën (evidenca 39), ku parashtrohen qëllimet e këtij komponenti të programeve që ofrohen nga UMSH, objektivat, strukturat përgjegjëse, ngarkesën dhe mënyrën e vlerësimit të praktikave. Institucioni gjithashtu ka parashikuar kërkesa që duhet të përbushen nga Institucionet ku do të kryhet praktika mësimore dhe ka përcaktuar se është Zyra e Këshillimit të Karrierës, struktura e cila informon studentët për mënyrën e zhvillimit të praktikës. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit është gjithashtu pjesë e dokumentacionit të dorëzuar (evidenca 19) <i>(Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Financë Bankë”. Evidenca 13 “Programi</i>

	<i>Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma</i> . Evidenca 19 “Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera”. Evidenca 39 “Udhëzimi për praktikat”.)			
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, krijën e mobiliteitit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Aktualisht programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë ofrohet në gjuhën shqipe. Literatura kryesore në të gjitha lëndët si edhe mësimdhënia kryhen në gjuhën shqipe. Nga shqyrtimi i programeve Indore, GVJ vrojtoi përdorimin e disa komponentëve të literaturës mbështetëse në gjuhën angleze, por megjithatë të pamjaftueshëm duke pasur parasysh se fusha e financë bankës karakterizohet nga terminologji shpesh herë tejet specifike dhe të fokusuar të fushës përkatëse.</p> <p>Bazuar në zgjerimin e kufizuar aktual të elementeve në gjuhë të huaj, GVJ këshillon që në të ardhmen Institucioni të konsiderojë një përfshirje më të madhe të elementëve të mësimdhënies në gjuhë të huaj, ndoshta mësimin në një lëndë specifike si Tregje dhe Institucione Financiare, Teknologji Financiare apo edhe investime, të cilat aktualisht nuk ofrohen as si lëndë me zgjedhje, ndërkohë që Teknologjitë e reja financiare listohen edhe si një ndër objektivat formuese së bashkë me rregulloren e programit, por nuk i ndeshim të përfshira në Planin Mësimor. Ofrimi i tyre në gjuhën angleze do të kontribuonte edhe drejt arritjes së synimeve strategjike të Ndërkombëtarizimit të Institucionit.</p> <p>(Evidenca 8 “Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH”. Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”.)</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Në RVB të paraqitur nga Institucioni raportohet se ky kriter plotësohet, pra se Institucioni përgatit dhe arkivon dokumentacionin edhe në gjuhën angleze, por në DVV nuk u gjetën dokumentacione apo referenca të nevojshme për një aktivitet të tillë. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, GVB këmbënguli që këto informacione disponoheshin dhe madje ishin të paraqitura edhe në ëbsite, por GVJ nuk e konfirmon ekzistencën e tyre. Pedagogët e programit të studimit u shprehën se syllabuset e lëndëve përgatiten edhe në gjuhën angleze.</p>			
<p>Shkallë e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Partialisht</p>	<p>Përqëndrisht kryesish</p>	<p>Jo përmbushur</p>
<p>X</p>			<p>X</p>	

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është Fakulteti i Shkencave Ekonomike, ndërsa njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Financë Bankë Kontabilitet. Nga shqyrtimi i tabelave në evidencën 18, GVJ konstaton se Institucioni disponon staf akademik të përshtatshëm për ofrimin e programit të studimit në këtë fushë.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Tabela 1 – Numri i Personelit Akademik për çdo njësi bazë" & "Tabela 2 – Personeli Akademik Efektiv dhe Personeli Akademik me Kontratë për çdo njësi bazë".)</i></p>										
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; organizohet me 120 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademik me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015. (Klasifikimi dhe kodifikimi i programeve të studimit për momentin, ende nuk ofrohet në vendin tonë.)</p>										
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare, e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Kjo është një program i fushës së shkencave ekonomike i cili ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike. Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit, konstatohet se ka përputhshmëri. Njësia bazë që është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe GVJ edhe këtu konstaton përputhshmëri të profilit akademik dhe kërkimor mes njësisë bazë dhe programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 5 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë", Evidenca 7 "Strategjia e zhvillimit të programit Master i Shkencave në Financë Bankë").</i></p>										
<p>Shikohet në tabelën e mëposhtme</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1534 766 1624">Niveli i kualifikimit</th> <th data-bbox="766 1534 925 1624">Klasifikimi</th> <th data-bbox="925 1534 1085 1624">Kodifikimi</th> <th data-bbox="1085 1534 1244 1624">Përdoruesi kryesor</th> <th data-bbox="1244 1534 1449 1624">Përdoruesi i plotë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 1624 766 1682">X</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td data-bbox="1244 1624 1449 1682">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i kualifikimit	Klasifikimi	Kodifikimi	Përdoruesi kryesor	Përdoruesi i plotë	X				X
Niveli i kualifikimit	Klasifikimi	Kodifikimi	Përdoruesi kryesor	Përdoruesi i plotë							
X				X							

Standardi I.5



Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ nga analiza e dokumentacionit të DVV si evidencat 1, 2, 3, 4 dhe 5, konstatoi ekzistencën e procedurave për ndarjen e detyrave mes njësive përgjegjëse kryesore dhe asaj bazë, ndarjen e përgjegjësive mes personelit të angazhuar për programin e studimit dhe kryerjen e analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Shihet gjithashtu se është bërë një parashikim i detajuar dhe i kujdesshëm i rolit të përgjegjës të njësive bazë, dhe koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike. Kjo ndarje e detyrave dhe përgjegjësive e parashikuar në dokumentat e dorëzuar, u konstatua nga GVJ edhe gjatë intervistave të kryera në vizitën në Institucion me stafin akademik, administrativ dhe strukturat drejtuese (dekanin dhe përgjegjësi i departamentit), GVJ dëshmon në këtë kriter një ngarkim detyrash administrative për personelin akademik, cka mund të ngarkojë këtë të fundit në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj procesit mësimor. Në lidhje me analizën e punës, GVJ konstaton se në UMSH bëhet analizë e rregullt periodike e performancës dhe punës së personelit akademik dhe atij administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2 "Rregullore e Organizimit të UMSH". Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike" Evidenca 4 "Rregullore e Departamentit të Financë Bankë Kontabilitet". Evidenca 5 "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë".)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në tabelën 5 të shtojcave të RVB, Institucioni ka listuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në kuadër të ofrimit të studimeve në programin Master i Shkencave në Financë Bankë. Duke qenë marrëveshje me partnerë nga bota e biznesit, autoritete ose ente shtetërore si edhe grupe bankare të njohura ndërkombëtare, GVJ është e mendimit se marrëveshjet ndihmojnë ndjeshëm UMSH në arritjen e objektivave të procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Tabelat e RVB – Tabela 5").</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit Institucional të deklaruara në evidencën 19 dhe më specifikisht marrëveshjet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë të deklaruara në tabelën 5 të RVB (evidenca 18), kanë një karakter të pasur me përfaqësues nga biznesi, institucionet financiare, ente rregullatore financiare, agjensi të njohura rekrutimi, etj. GVJ është e mendimit se këto marrëveshje lehtësojnë realizimin e praktikave mësimore për studentët e programit.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Përvec marrëveshjeve, UMSH ka hartuar edhe Udhëzimin për praktikën (evidenca 39, pika 8), në të cilin ka përshkruar me detaje natyrën e angazhimit që do të duhet të tregojnë institucionet partnere në kuadrin e ofrimit të praktikave mësimore dhe profesionale. Nga këto partnerë kërkohet të ofrojnë kushte të përshtatshme për praktikën, të ofrojnë mundësi për përfitimi eksperience, të caktojnë një person përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së praktikës mësimore, të plotësojnë një formular për vlerësimin e ecurisë gjatë praktikës dhe të informojnë studentin dhe pedagogun përgjegjës të UMSH për çdo pengesë që mund të jetë hasur gjatë praktikës.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Tabelat e RVB – Tabela 5". Evidenca 19 "Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera". Evidenca 39 "Udhëzimi për praktikën")</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UMSH deklaron se është pjesëtare e marrëveshjeve Erasmus + për garantimin e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë. Nxitja e bashkëpunimeve në kuadrin e aktivitetit kërkimor, është e parashikuar edhe në Strategjinë për Ndërkombëtarizimin e UMSH (evidenca 8, synimi strategjik numër 2). Në DVV u gjetën të dhëna në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit mes Institucionit dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera.</p> <p><i>(Evidenca 19 "Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera". Evidenca 8 "Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH".)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njëjësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Për këtë kriter në RVB e përgatitur nga Institucioni deklarohet se UMSH analizon rregullisht marrëveshjet e bashkëpunimit për të evidentuar përfitimet në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit, por GVJ nuk gjeti evidencë të këtyre analizave dhe aq më pak raportim analitik të tyre. Të pyetur gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm nuk arriti të jepte një përgjigje të kënaqshme në lidhje me këtë kriter, ndaj GVJ e gjykon kriterin të përmbushur kryesisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit</p>	<p>Theksi i vendosur në strategjinë e UMSH për ndërkombëtarizimin konfirmim mbështetjen formale institucionale në favor të personelit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 19

<p>shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>akademik dhe studentëve për angazhimin e tyre në aktivitete kërkimore të ndryshme (evidenca 8, synimi strategjik numër 2).</p> <p>Më tej, nga shqyrtimi i analizës vjetore të aktivitetit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike (evidenca 22), aksesohen të dhëna në lidhje me angazhimin e stafit akademik në aktivitete kërkimore si projekte të ndryshme, botime në revista të indeksuara ose referime në konferenca shkencore.</p> <p>GVJ shqyrtoi edhe faqen e internetit të institucionit dhe konstatoi se UMSH është botuese e një reviste shkencore periodike, Euro Mediterranean, ka një shtepi botuese UMSH Press dhe organizon konferenca shkencore, më e fundit në qershor 2020.</p> <p><i>(Evidenca 8 "Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH". Evidenca 22 "Analiza Vjetore e FSHE". https://ëëë.umsh.edu.al/c/5/krkimi-shkencor https://ëëë.umsh.edu.al/c/115/arkiva-konferenca)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në RVB Institucioni deklaroi se e ka ngritur një njësi të tillë, por nuk jep detaje për kohën, emërtimin, dhe përgjegjësitë e kësaj njësie, një tipar ky i RVB që haset në disa prej kriterëve. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi u shpreh i gatshëm të siguronin evidenca shtesë. GVJ mbështetur në dokumentin 4.1 të evidencave shtesë, konfirmon cilësinë e raportimit nga UMSH mbi ecurinë e rezultateve të kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Strategjia për ndërkombëtarizimin e institucionit duke pasur theks të rëndësishëm në fushën e kërkimit shkencor nënkupton edhe hartimin dhe ndjekjen e politikave për promovimin e rezultateve. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion stafi konfirmoi se herë pas here, në përputhje me kërkesat e stafit dhe prioritetëve ka incentive financiare dhe mbështetje për përfaqësim në konferenca ndërkombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 8 "Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH". Evidenca shtesë 4.1 dhe 5.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Në RVB institucioni deklaroi se është i angazhuar të respektojë ligjin për të drejtën e autorit (Ligji nr 35/016). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se Institucioni kujdeset të sigurojë të drejtën e autorit për titujt e teksteve dhe botimeve që janë përfshirë në literaturën bazë dhe atë mbështetëse për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni dhe stafi akademik përpiqen dhe kanë arritur të përfshijnë studentët e programit Master i Shkencave në Financë Bankë, në punime shkencore (tabela 22 në RVB, evidenca 18). Por nuk u gjet linku apo ndonjë referencë tjetër se ku ishin paraqitur apo botuar këto punime, apo për çfarë projektësh bëhet fjalë. GVJ u interesua për këtë fakt gjatë vizitës në Institucion dhe studentët e programit, por edhe stafi akademik konfirmuan angazhimin e studentëve në projekte kërkimore dhe botime artikujsh. Evidencë shtesë u siguruar nga Institucioni pas kërkesës së GVJ.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 20

	Referenca nga DVV: Evidenca 18 "Tabelat e RVB – Tabela 22".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë i ofruar në UMSH, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit është program i ciklit të dytë, me kohë të plotë me një kohëzgjatje 2 vjet dhe 4 semestra (vjeshtë dhe pranverë), në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë "Master i Shkencave në Financë Bankë". Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe. Diplomimi bëhet me punim diplome (evidenca 5)</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit (shtojca 2.1), GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina</p>

	<p>të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim.)</p> <p><i>(Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit MScFB”. Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit dhe i syllabus të lëndëve përkatëse (evidenca 13), GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje të parashikuara ofron një mbulim deri diku të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e Financës dhe Bankës. Studentët pajisen me njohuri në një larmi lëndësh bazë dhe formuese si teknikat bankare, menaxhimi strategjik, drejtimi financiar, auditimi, teknika bashkëkohore të analizave financiare etj. Këto njohuri vlejné jo vetëm për profesionet e specialistit të financës apo bankës por edhe auditimit, analistit financiar, konsulentit, etj.</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë i ofruar në UMSH i përket Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe synon të mundësojë njohuritë themelore për metodat dhe parimet, si dhe aftësitë specifike në një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe më tej të Syllabuseve të Lëndëve, GVJ konstaton se ky program planifikon të japë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit Financë dhe Bankë si edhe i aftëson studentët <u>vetëm kryesisht</u> për punësim të mëtejshëm në këta sektorë. Për të rritur nivelin e përgatitjes së studentëve dhe për t’i aftësuar ata për problem zgjidhje komplekse të disiplinave të integruara, nga ana e GVJ sugjerohet që në planin mësimor të shtohen lëndë që mbulojnë edhe aspekte të tjera të nevojshme të profesionit të financierit / bankierit si: “Tregjet dhe Institucione Financiare”, “Teknologjinë Financiare apo Investimet” dhe “Menaxhimin e Portofolit”.</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të parashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë paraqitet i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Elementët e programit të studimit janë në përputhje kryesisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë paraqitet i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Elementët e programit të studimit janë në përputhje kryesisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 22

	<p>(VKM), nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar me VKM nr. 879 dt. 18.12.2019. Ai është i organizuar në pesë disiplinat formuese (A – E), ka 120 kredite, zgjat dy vite akademike, mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, dhe është i detyrueshëm për frekuentim në masën 75% (evidenca 13.)</p> <p>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten kryesisht në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht VKM nr.41 përsa i përket strukturimit të tyre. Ato përmbanin këta seksione: Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, konceptet thmeleore, temat e lëndëve së bashku më nëncështjet dhe faqet përkatëse nga literatura, format e kontrollit të dijeve, vlerësimin e vazhdueshëm dhe frekuentimin si edhe literaturën bazë dhe atë të sugjeruar</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i Studimit sic konfirmohet edhe nga shqyrtimi i evidencave 13 dhe 18, ka një shpërndarje të lëndëve dhe moduleve sipas kategorive, në ECTS në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): – gjithsej 8 ECTS, 7% e totalit (duhet të jetë nga 5% - 10% e krediteve totale sipas VKM 41, shtojca 1, tabela 1) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues: gjithsej 64 ECTS, 53% e totalit, (duhet të jetë nga 50% - 60% sipas VKM 41, shtojca 1, tabela 1). - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): gjithsej 18 ECTS, 15% e totalit, (duhet të jetë nga 12% - 20% sipas VKM 41, shtojca 1, tabela 1) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): gjithsej 12 ECTS, pra 10% e totalit, (duhet të jetë 10% e krediteve totale sipas VKM 41, shtojca 1, tabela 1) - Kategoria E (detyrimet përmblylëse: projekti i diplomimit ose provimi përfundimtar gjithëpërfshirës): gjithsej 18 ECTS (15%) (duhet të jetë nga 10% - 15% sipas VKM 41, shtojca 1, tabela 1)
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>(Nga më lart konstatohet se në përputhje me kërkesat e VKM nr 41, shumica e ECTS në disiplinat A dhe B është jo më pak se 60%). Rregullorja e programit të studimit parashikon se diplomimi kryhet nëpërmjet punimit të një teme diplome dhe ka përshkruar aktivitetet dhe procedurat e nevojshme që studentët duhet të realizojnë për t'u</p>

	<p>diplomuar. Në mënyrë më të detajuar këto aktivitete tregohen edhe në evidencën 14 “Udhëzim për Përgatitjen e Diplomës”.</p> <p>(Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit MScFB”. Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”. Evidenca 14 “Udhëzim për Përgatitjen e Diplomës”. Evidenca 18, Tabela 9 Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese”)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Institucioni është akredituar në vitin 2020. Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është Fakulteti i Shkencave Ekonomike i cili përbëhet nga tre njësi bazë. Njëra nga këto, Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit është përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi. Fakulteti i Shkencave Ekonomike ofron gjithsej 8 programe studimi: 1 program profesional jo universitar, 2 programe Bachelor, 3 programe studimi Master i Shkencave, 2 programe Master Profesional (Tabela 3, evidenca 18).</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është hapur për herë të parë në vitin akademik 2011 – 2012 sipas Urdhërit Nr. 482, datë 03.10.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe u akreditua për herë të parë në korrik të vitit 2012. Në përputhje me kërkesat e reja të Ligjit të ri për arsimin e lartë, ky program u riakreditua në vitin 2018.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të ligjit të A.L “Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Shkencave Ekonomike i UMSH, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë (evidenca 3) duke plotësuar kështu këtë kërkesë ligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor, • Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe,
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

- Departamenti i Ekonomisë.

Referuar të dhënave shoqëruese të RVB (Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 18), si edhe pas konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, përbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada).

Të dhëna analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitetit në vitet që nga akreditimi i mëparshëm (viti 2018) paraqiten më poshtë: (PAE – Personel Akademik Efektiv; PAK – Personel Akademik me Kontratë; PNA – Personel Ndihmës Akademik)

Dep Financë, Bankë, Kontabilitet	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	3	2	3	2	3
Prof.As	1	2	2	1	3	1
Dr	2	4	4	2	3	2
MSc	7	3	8	4	7	1
Total	12	12	16	10	15	7
PNA	0	0	0	0	0	0

(Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Evidenca 18, Tabela 2 "Numri i personelit akademik për njësinë bazë").

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Sic u përmend edhe më lart GVJ konfirmon se Fakulteti i Shkencave Ekonomike të UMSH, ka në përbërjen e tij tre departamente (Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe Departamenti i Ekonomisë) duke përbushur kërkesën e nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Të dhëna analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike në vitet që nga akreditimi i mëparshëm (viti 2018) paraqiten më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Ekonomike	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	5	10	6	8	5	6
Prof.As	3	4	4	3	4	2
Dr	13	5	16	2	17	3
MSc	20	7	26	4	28	2
Total	41	26	52	17	54	13
PNA	0	0	0	0	0	0

	<i>(Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Evidenca 18, Tabela 1 "Numri i personelit akademik për cdo njësi bazë të FSHE")</i>			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Nga shqyrtimi i tabelave përbërëse në evidencën 18 dhe sipas raportimit analitik të përbërjes së stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitetit, të paraqitur në kriteret 2, 3 dhe 4 më lart, GVJ konstaton se Institucioni nuk angazhon personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore apo projekteve studimore – kërkimore. Pavarësisht kësaj, Institucioni deklaron në RVB ekzistencën dhe angazhimin maksimal të personelit ndihmës! Të pyetur për këtë gjatë vizitës në Institucion GVB u shpreh se si personel ndihmës akademik ata konsiderojnë stafin administrativ që ndihmon në realizimin e detyrave akademike. GVJ nuk e gjykon të mjaftueshme këtë deklaratë për të konkluduar përmbushje të plotë të këtij kriteri. <i>(Evidenca 18, Tabela 1 "Numri i personelit akademik për cdo njësi bazë të FSHE").</i>			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Neni 20 i Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike, FSHE, sanksionon caktimin e një koordinatori për programet Master Shkencor dhe Profesional të ofruara nga kjo njësi kryesore. Sipas kësaj rregulloreje, koordinatori kujdeset të bashkërendojë programet e ciklit të dytë në FSHE dhe realizimin e misionit dhe veprimtarisë së këtyre programeve. Koordinatori është anëtar i personelit akademik të fakultetit (neni 20, pika 1), propozohet nga Dekani dhe miratohet nga Rektori (neni 20, pika 3).			
Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë në nenin 7 përshkruan në mënyrë edhe më të detajuar rolin e koordinorit të programit duke i atribuar përgjegjësi si: drejtimi i punës për miratimin e planeve mësimore; bashkërendimin e shpërndarjes së ngarkesës; propozimin tek Dekani të orarit mësimor dhe kalendarit të provimeve; dhe sic kriteri e kërkon edhe raportimin tek dekani për mbarëvajtjen e procesit të praktikave dhe diplomimit për programet e ciklit të dytë. <i>(Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Evidenca 5 "Rregullore e Programit të Studimit MScFB".)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV (Rregullorja e programit të studimit, Udhëzuesi i Studentit; Plani Mësimor i Programit të Studimit) si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit Master i Shkencavë në Financë Bankë disponohen nga Fakulteti (njësia kryesore) dhe Departamenti (njësia bazë) si edhe janë bërë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht.</p> <p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi gjithashtu se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit pasi njoftohen qysh në fillim të studimeve nëpërmjet Broshurës së programit Master, por edhe në fillim të cdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve specifike.</p> <p><i>(Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Evidenca 5 "Rregullore e Programit të Studimit MScFB". Evidenca 38 "Udhëzuesi i Studentit".</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5ee69d5f5533c.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë në UMSH, GVJ konstatoi se programi i studimit është i organizuar në module të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje të kategorizuara në 5 aktivitete formuese (A-E) sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si edhe Udhëzimit nr 41, 2018 të ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Lëndët dhe modulet janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit European, ECTS. Sipas Planit Mësimor të Programit të studimit, lëndët janë të organizuara në dy vite akademike dhe katër semestra. Në semestrin e parë të vitit të parë kryhen katër lëndë të detyrueshme, kurse në semestrin e dytë të vitit të parë kryhet një lëndë e detyrueshme, një lëndë me module dhe dy lëndë me zgjedhje. Në semestrin e parë të vitit të dytë kryhen katër lëndë gjithsej, ku dy lëndë janë të detyrueshme, një lëndë modulare dhe një lëndë me zgjedhje. Në semestrin e dytë të vitit të dytë studentët angazhohen vetëm në praktikën mësimore dhe përgatitjen e diplomës.</p> <p>Praktika profesionale është pjesë e programit të studimit dhe kryhet në semestrin e fundit të studimeve. Ajo ka gjithsej 12 kredite ECTS dhe kryhet pranë Institucioneve me të cilat UMSH ka marrëdhënie bashkëpunimi.</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p><i>(Evidenca 18, Tabela 9 "Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese", Tabela 10 "Plani Mësimor i Programit të Studimit")</i></p> <p>Nga shqyrtimi i tabelës 10 në evidencën 18 – Tabelat e RVB, GVJ konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, Institucioni ka përgatitur një plan mësimor të detajuar ku për cdo lëndë të detyrueshme apo me zgjedhje konstatohet informacni në lidhje me semestrin kur zhvillohet, ngarkesa mësimore në ECTS, orët në javë të ndara në orë në auditor dhe orë studimi individual, për cdo aktivitet si leksione, seminare apo laboratorë. Në planin mësimor paraqitet edhe mënyra e vlerësimit final të dijeve për cdo lëndë dhe që është provimi me shkrim.</p> <p>Elementi i frekuentimit / ndjekjes së programit paraqitet në programet lëndore të vecanta dhe është në masën 75%. Gjithashtu në programet lëndore gjejmë edhe vlerësimet e detajuara për cdo lëndë të cilat janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivizimi në seminare 10% • Detyra dhe prezantime 20% • Provimi i ndërmjetëm 30 % • Provimi përfundimtar 40% • Totali 100% <p>Në bazë të Rregullorës së Programit të Studimit, detyrim frekuentimi është 75% e orëve mësimore në auditor.</p> <p><i>(Evidenca 18, Tabela 10 "Plani Mësimor i Programit të Studimit" & Tabela 15 "Format e Kontrollit të njohurive". Evidenca 13 "Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma".)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV për këtë kriter, GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë ka këto kritere për pranimin e kandidatëve:</p> <p>Kandidatët që dëshirojnë të frekuentojnë programin e studimit "Master i Shkencave në Financë, Bankë" duhet të plotësojnë kriteret e renditura në nenin 12 të evidencës 5 "Mbi pranimet e studentëve", të cilat lidhen me përfundimin e studimeve Bachelor me 180 ECTS pranë një universiteti tjetër publik ose privat shqiptar ose shqipfolës dhe njohja e një prej pesë gjuhëve të BE.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë mund të pranohen edhe kandidatë pa plotësim kreditesh por nëse kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkencë ekonomike pranë UMSH, ose ciklin e parë të studimeve në Financë, Bankë, Kontabilitet ose profile të ngjashme pranë një Universiteti tjetër në Shqipëri ose</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 28

jashtë, gjithmonë në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave. Sipas nenit 12 të Rregullores së Programit të Studimit, pranimi i këtyre studentëve në programin e studimit MScFB i nënshtrohet fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përcaktohen edhe kreditet shtesë që kandidatët duhet të plotësojnë para hyrjes në programin e studimit. Sipas konfirmimeve në Institucion, dekani dhe përgjegjësi i departamentit konfirmuan këtë procedurë.

Sic duket nga neni 12, evidenca 5, kriter për mesataren nuk ka dhe as për profilin e studimeve të ciklit të parë për ata kandidatë që kanë marrë 180 ECTS. GVJ këshillon përfshirjen e një kriteri për mesataren si edhe kriterin për përfundimin e studimeve Bachelor në një profil të shkencave ekonomike, duke qenë se ky është një program studimi i Masterit Shkencor dhe duhet të ketë një nivel të cilësisë në hyrje për kandidatët.

GVJ nuk konstatoi kriteret specifike të pranimit të kandidatëve në këtë program studimi.

Në lidhje me procedurën e transferimeve, Institucioni ka dorëzuar si pjesë e DVV, një përmbledhje të procedurës së transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Baza ligjore për këtë procedurë është neni 76 i Statutit të UMSH, nenet 68 & 69 të Rregullores së Organizimit të UMSH, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Rregullore të MASR.

Studentët që dëshirojnë të transferohen në hyrje pranë këtij programi studimi të UMSH paraqesin një kërkesë nëpërmjet sekretarisë mësimor pranë Dekanit të FSHE; Dekani më pas propozon një komision transferimi i cili përbëhet nga tre anëtarë minimalisht. Komisioni shqyrton dosjen e transferimit dhe përpilon një raport ku evidenton: lëndët dhe programet që njihen dhe ekuivalentohen nga UMSH; lëndët që studenti duhet t'i japë provim; lëndët që studenti duhet t'i frekuentojë rregullisht. Lista e studentëve që plotësojnë kriteret i dërgohet për miratim dekanit të FSHE, vendimi i të cilit më pas i përcillet sekretarisë mësimore.

Studentët që dëshirojnë të transferohen në dalje nga UMSH në një Institucion tjetër i paraqesin një kërkesë dekanit të njësisë kryesore që ofron programin e studimit, në këtë rast Fakulteti i Shkencave Ekonomike. Dekani miraton kërkesën dhe me këtë miratim, studentit i vihet në dispozicion Lista e notave së bashku me kreditet përkatëse, vërtetimi i statusit të studentit dhe dokumentacioni që ka doëzuar për regjistrimin e tij.

	<p>Tabela 21 në evidencën 18, Tabelat e RVB jep informacion për numrin e studentëve të transferuar në hyrje për këtë program studimi dhe që është: 16 studentë për vitin 2018 – 2019; 9 studentë për vitin 2019 – 2020; 4 studentë për vitin 2020 – 2021. Tabela nuk jep informacion për studentët e transferuar në dalje dhe nëse ka të tillë.</p> <p><i>(Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”. Evidenca 5 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë”. Evidenca 18, Tabela 21 “Cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje”. Evidenca 41 “Përmbledhje e procedurës së transferimeve”)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e dokumentacionit të DVV (evidenca 13). Referuar këtyre të dhënave, GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me orët në auditor, seminarin (nëse ka) dhe orë laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41. Në këto programe lëndore paraqiten edhe komponentë si mënyra e vlerësimit që ndiqet për cdo komponent si vlerësime gjatë vitit, detyra dhe prezantime, provimi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar (shiko kriteri 4 më lart); literatura bazë dhe e sugjeruar, detajimi i programi lëndor në çështje dhe nëncështje shoqëruar me faqet përkatëse referencë në literaturën e detyrueshme.</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga ana e Institucionit për këtë kriter deklarohet se ndiqen procedurat e parashikuara për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave por këto deklarata nuk shoqërohen me ndonjë referencë të dobishme që GVJ të mund të konstatojë kryerjen e këtyre aktiviteteve dhe aq më pak arkivimin e dokumentacionit të kërkuar. Për këtë arsye GVJ shqyrtoi dokumentacionin ku në lidhje me përmirësimin e kurrikulave ndeshi evidencë në pikën 6.4 të dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të programit MScFB. Spas këtij dokumenti pedagogët organizohen sips grup lëndëve dhe angazhohen në diskutime në lidhje me mënyrat e përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave që ata mbulojnë në mënyrë që të arrihen objektivat formuese të programit të studimit por edhe që të mos ketë përsëritje të dijeve dhe koncepteve mes lëndëve të ndryshme.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, për procedurën e përmirësimit të programeve mësimore dhe arkivimin e ndryshimeve në një dosje të plotë me materiale në gjuhën shqipe dhe atë angleze, stafi akademik konfirmoi rishikimin e syllabuseve cdo vit me dy objektiva në fokus. 1 - të hiqen përsëritjet mes lëndëve të ndryshme. 2 - Të futen pjesë të reja të lëndës që janë të përditësuara. Departamenti e diskuton në bazë</p>




	<p>të propozimit të pedagogut me relacion shoqëruar syllabusit dhe e miraton shefi i departamentit. Po kështu, stafi konfirmoi edhe ruajtjen e arkivimit të syllabuseve në gjuhën angleze. GVJ formoi bindjen se pedagogët bëjnë përpjekje për të përmirësuar përmbajtjen e lëndëve në funksion të arritjes së objektivave të lëndëve.</p> <p><i>(Evidenca 7 “Strategjia e Zhvillimit të Programit MScFB”).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Për këtë kriter, GVJ i është referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 73 pika 1, i cili kërkon që programet e Masterit të Shkencave, të organizohen me jo më pak se 120 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre të jetë dy vite akademike.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë i ofruar nga UMSH, është i hartuar dhe organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, i shtrirë në dy vite akademike me nga 60 ECTS, pra 120 ECTS në total duke mundësuar përmbushjen e këtij kriteri. (më shumë detaje në kriterin II.3.3 më lart).</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke gjykuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, (Plani Mësimor i programit të studimit, programet lëndore, baza e literaturës, CV e profesorëve të angazhuar me këtë program studimi), GVJ mund të shprehet se ky program mundëson kryesisht aftësimin e studentëve me objektivat e synuara për programin e studimit, me kompetencat e parashikuara në syllabuse duke lehtësuar punësimin e tyre në treg në të ardhmen, ose vazhdimin e studimeve më të thelluara të mëtejshme.</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit që është pjesë e DVV, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy vitet akademike sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e mirë menduar dhe mundëson kryesisht arritjen e</p>

<p>studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>objektivave formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Studentët e programit kanë mundësinë të marrin lëndën e Metodave të Kërkimit Shkencor e cila, sipas temave të përshkruara në Syllabusin përkatës, i pajis studentët me aftësi dhe koncepte për të realizuar projekte kërkimore individuale. Më tej, në lëndët e programit, studentët kanë mundësinë të pëgatisin dhe prezantojnë projekte kërkimore në formën e detyrave të kursit.</p> <p><i>(Evidenca 13 "Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma")</i></p>						
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat në RVB (evidenca 18) si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë në UMSH, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm dhe të mjaftueshëm sipas kërkesave të profilit dhe fushës së programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, sipas njohjes që anëtarët e GVJ kanë me programe studimi ndërkombëtare në fushën e Financë Bankës.</p> <p>Por, megjithatë, bazuar në tendencat më të fundit të zhvillimeve të kurrikulave në fushën financiare dhe bankare, GVJ sugjeron shtimin e gamës së lëndëve me zgjedhje të ofruara për studentët, në mënyrë që ata të pajisen me njohuri që kanë fituar interes në programe të ngjashme ndërkombëtare. Vecojmë këtu edhe njëherë lëndët e Tregjeve dhe Institucioneve Financiare, Investime, Menaxhim i Portofolit, Teknologji Financiare, etj. Po ashtu mund të bëhet një rishikim natyrisht brenda normave të lejuara nga ligji, i disa prej lëndëve të detyrueshme psh Marketingu Bankar apo Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare” të cilët mund të përshtaten më mirë me fokusin e programit të studimit”. Mbështetur në diskutimin me studentët e programit dhe nevojat e këtyre të fundit konstatuar gjatë përvojës në punë, e rëndësishme konstatohet edhe pasurimi i ofertës akademike me lëndë të programeve kompjuterike në kontabilitet, si Financa 5.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit")</i></p>						
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese të këtij programi është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, sic edhe është treguar në kriteret më lart nga ana e GVJ. Përsa i përket strukturës së programit në tërësi dhe detajimit të tij në raportet teori/praktikë gjemë sa më poshtë: (tabela 13, evidenca 18)</p> <table data-bbox="654 1702 1404 1859"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>465 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare</td> <td>315 orë</td> </tr> <tr> <td>• Ushtrime / Laboratore</td> <td>75 orë</td> </tr> </table>	• Leksione	465 orë	• Seminare	315 orë	• Ushtrime / Laboratore	75 orë
• Leksione	465 orë						
• Seminare	315 orë						
• Ushtrime / Laboratore	75 orë						

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor 0 orë • Praktikë profesionale 24 orë • Diploma/ Provim Formimi 30 orë <p>Totali 909 orë</p> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt prof) rezulton 465 orë teori / 444 ore praktikë, ose afërsisht 51% / 49%.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen seminare, ushtrime, laboratore dhe praktika, por përmendim në mënyrë specifike edhe numri e lartë të orëve të laboratorit.</p> <p>Evidenca për punësimin e studentëve GVJ gjeti edhe në tabelën 23 të evidencës 18.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit", Tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor" dhe tabela 23 "Numri total i të punësuarve").</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me përditësimin e syllabuseve, RVB e përgatitur nga Institucioni referon se ato azhornohen vazhdimisht nga lektori i lëndës duke marrë eksperiencën më të mirë të lëndëve të ngjashme të ofruara nga programe studimit të ngjashme. Referohet gjithashtu se literatura është kryesisht e 5 viteve të fundit, por ka disa përjashtime për të cilat pjesëtarët e stafit pedagogjik u justifikuan se nuk ka pasur botime më të fundit nga ana e autorëve përkatës, (psh, evidenca 13 faqja 21 sa për ilustrim por ka disa të tilla).</p> <p>GVJ këshillon që për ato situata ku literatura bazë nuk i përket 5 viteve të fundit, pedagogët të përfshijnë në syllabuse materiale mbështetëse të marra nga aksesit në bibliotekat online të Institucionit (p.sh, Questia). Kështu do të mund të plotësohet krejtësisht ky kriter.</p> <p><i>(Evidenca 13 "Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma")</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në analizën e tërësisë së programeve lëndore për të gjithë semestrat e studimit, GVJ arrin në përfundimin se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve, çështjeve të trajtuara në cdo lëndë, nivelit të trajtimit të problematikave dhe elementeve të caktuara mundëson kryesisht përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të dytë.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përsa i përket aftësive analitike dhe shkencore në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten të kompletuara kryesisht dhe lejojnë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33

<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>kombinimi i aktiviteteve teorike dhe kërkimore shkencore të këtij programi studimi, ndërton tek studentët një nivel kryesisht të pranueshëm të njohurive të avancuara për studime, kërkime dhe analiza shkencore të thelluara. GVJ thekson përmbushjen kryesisht, pasi në elemente të caktuara përmbajtja e programit të studimit mund të pasurohet apo thellohet/diversifikohet më tej duke ofruar disa lëndë me zgjedhje që janë të dobishme për studentët e masterit shkencor në Financë Bankë (opinion i detajuar i GVJ në lidhje me këtë pikë është shtjelluar pak më lart në kriterin II.4.4).</p> <p><i>(Evidenca 13 "Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma")</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, deklarohet se kriter përmbushet plotësisht pasi Institucioni ka partnerë dhe bashkëpunëtorë, propozimet e të cilëve merren parasysh, por pa dhënë referenca të dobishme që dokumentojnë këto deklarata. Gjatë analizës së dokumentacionit, GVJ nuk ndeshi evidencë për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit duke marrë parasysh propozime nga bashkëpunëtorët dhe tregu i punës. Pyetur gjatë vizitës në Institucion, anëtarë të GVB u shprehën se ata mbajnë kontakte të vazhdueshme me aktorë të tregut të punës dhe fryt i këtyre kontakteve ishin edhe reflektimet në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit. Pra tendenca e tregut të punës është marrë nga kontaktet me bordin e tregut të punës, alumni dhe takime të shpeshta me ta gjatë vitit akademik. Reflektimet nga këto takime janë pasqyruar në përmirësime të programit të studimit. Psh standardet e raportimit financiar ndërkombëtare që ishin fillimisht u pasuruan edhe me standardet e raportimit kombëtare, në lëndën e Kontabilitetit Financiar duke e riorganizuar këtë të fundit në një lëndë me dy module: standarde kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit. Osc auditimi që filloi gjithashtu të ofrohej me module: auditim i brendshëm dhe auditim i jashtëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																							
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si edhe gjatë vizitave në Institucion konstaton se njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit.</p> <p>Në tabelën 4 të evidencës 18 jepet informacion i detajuar në lidhje me titullin akademik dhe ngarkesën e personelit akademik efektiv (PAE) dhe atij me kontratë (PAK), si në total pranë Institucionit, ashtu edhe në mënyrë direkte për këtë program studimi specifik. Por ky informacion për orët mësimore jepet vetëm për vitin akademik aktual (2020 - 2021), dhe në tabelat 6 të të njëjtës evidencë jepen informacione më të detajuara në lidhje me gradën apo titullin e stafit akademik. Tabela më poshtë tregon të dhëna për numrat e personelit të angazhuar pranë këtij programi studimi:</p>																																																																							
<table border="1"> <thead> <tr> <th>2020</th> <th>2021</th> <th>2019</th> <th>2020</th> <th>2018</th> <th>2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>6</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	2020	2021	2019	2020	2018	2019	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	1	1	1	1	1	1	8	3	2	5	5	2	10	4	3	6	6	3	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> <th colspan="2">2018 - 2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>8</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>10</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>8</td> </tr> </tbody> </table>	Stafi akademik i programit të studimit	2020 - 2021		2019 - 2020		2018 - 2019		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	3	1	3	-	5	Prof.As.Dr	1	1	-	1	-	1	Dr/PhD	8	-	6	1	5	2	Total	10	4	7	5	5	8
2020	2021	2019	2020	2018	2019																																																																			
PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																			
1	1	1	1	1	1																																																																			
8	3	2	5	5	2																																																																			
10	4	3	6	6	3																																																																			
Stafi akademik i programit të studimit	2020 - 2021		2019 - 2020		2018 - 2019																																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																		
Prof.Dr	1	3	1	3	-	5																																																																		
Prof.As.Dr	1	1	-	1	-	1																																																																		
Dr/PhD	8	-	6	1	5	2																																																																		
Total	10	4	7	5	5	8																																																																		
<p>Shohim se në programin e studimit angazhohet personel akademik i gradës "Doktor i Shkencave" dhe më lart, duke e përbushur këtë kërkesë ligjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në vitin e fundit akademik 2020 - 2021, nga 14 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 4 janë PAK dhe 10 PAE duke qëndruar në raportet 29 % / 71 %. Përsa i përket ngarkesës akademike që ata mbulojnë nga 1.245 orë totale për programin e studimit për vitin akademik 2020 - 2021, 345 orë realizohen nga PAK dhe 900 orë realizohen nga PAE duke dhënë një raport 28 % / 72% përkatësisht PAK / PAE. Në vitin akademik 2019 - 2020, nga 12 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 5 janë PAK dhe 7 PAE duke qëndruar në raportet 42 % / 58 % duke mos i plotësuar kërkesat ligjore për raporte minimale 30 % / 70 %. Në vitin 2018 - 2019, nga 13 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 8 janë PAK dhe 5 PAE duke qëndruar në raportet 62 % / 38 % duke mos i plotësuar kërkesat ligjore për raporte minimale 30 % / 70 %. 	<p>Shohim se në programin e studimit angazhohet personel akademik i gradës "Doktor i Shkencave" dhe më lart, duke e përbushur këtë kërkesë ligjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në vitin e fundit akademik 2020 - 2021, nga 14 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 4 janë PAK dhe 10 PAE duke qëndruar në raportet 29 % / 71 %. Përsa i përket ngarkesës akademike që ata mbulojnë nga 1.245 orë totale për programin e studimit për vitin akademik 2020 - 2021, 345 orë realizohen nga PAK dhe 900 orë realizohen nga PAE duke dhënë një raport 28 % / 72% përkatësisht PAK / PAE. Në vitin akademik 2019 - 2020, nga 12 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 5 janë PAK dhe 7 PAE duke qëndruar në raportet 42 % / 58 % duke mos i plotësuar kërkesat ligjore për raporte minimale 30 % / 70 %. Në vitin 2018 - 2019, nga 13 anëtarë të personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë 8 janë PAK dhe 5 PAE duke qëndruar në raportet 62 % / 38 % duke mos i plotësuar kërkesat ligjore për raporte minimale 30 % / 70 %. 																																																																							

	<p>Përsa i përket ngarkesës akademike për vitet 2018 – 2019 dhe 2019 - 2020 nuk ka të dhëna në dokumentat e dorëzuara paraprakisht dhe edhe kur këto u kërkuan gjatë vizitës në Institucion, nuk u vunë në dispozicion nga ky i fundit me argumentimin se tabelat janë plotësuar pikërisht sic i kërkon ASCAL. Për këto dy vite akademike GVJ vëren mos përmbushjen e kriterit ligjor për një raport minimal prej 70% të personelit akademik efektiv.</p> <p><i>(Evidenca 18 “Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit”, Tabela 4 “Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit”, & Tabela 6 “Cilësia e Stafit Mësimdhënës për programin e studimit” & Tabela 7 “Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit sipas kualifikimit dhe raportet mes tyre”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vuri re se personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, kishte grada e tituj (referim edhe të dhënat e detajuara të raportuara në kriterin më lart). Në të vërtetë shumica e tyre (8 nga 10), kishin gradën shkencore Doktor dhe vetëm dy kishin tituj akademikë Profesor ose Profesor i Asociuar. Ndërkohë personeli akademik me kontratë ishin të gjithë të kategorisë profesorë (tre profesorë dhe një profesor i asociuar).</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të stafit, sfondi i formimit akademik, angazhimi praktik në fushën e financë bankës, si edhe profili akademik i personelit, GVJ konstaton se personeli shfaqet në përgjithësi, në përputhje me angazhimin e tyre në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV të stafit, sfondi i formimit akademik, angazhimi praktik në fushën e financë bankës, si edhe profili akademik i personelit, GVJ konstaton se personeli shfaqet në përgjithësi, në përputhje me angazhimin e tyre në programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 13 “Programi Master i Shkencave në Financë Bankë – Plani Mësimor, Syllabus, CV dhe Diploma”. Evidenca 18 “Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit”, Tabela 6 “Cilësia e Stafit Mësimdhënës për programin e studimit”.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, si edhe të dhënat në DVV dëshmojnë një sërë marrëveshje të nënshkruara me institucione partnere, biznese dhe institucione të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave profesionale. Në evidencën 19 dhe në tabelën 5 në evidencën 18, listohen Institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi, edhe në mënyrë specifike për këtë program studimi.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me studentët konfirmoi mënyrën e realizimit të procesit të përgatitjes së diplomës dhe praktikës profesionale, në dispozicion të të cilave studentët kanë të gjithë semestrin e fundit të studimeve të tyre. Në lidhje me punimin e temës së diplomës Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e referon në Udhëzimin për Përgatitjen e Diplomës (evidenca 14). Gjatë procesit të punimit të diplomës, studentët udhëhiqen nga pedagogë udhëheqës shkencor, të cilët kanë minimalisht gradën shkencore Doktor.</p>

	<p>Në lidhje me praktikat profesionale, Institucioni ka hartuar Udhëzimin për Praktikën (evidenca 39), në të cilin ka përshkruar me detaje natyrën e angazhimit që do të duhet të tregojnë institucionet partnere në kuadrin e ofrimit të praktikave mësimore dhe profesionale. Nga këto partnerë kërkohet të ofrojnë kushte të përshtatshme për praktikën, të ofrojnë mundësi për përfitimi eksperience, të caktojnë një person përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së praktikës mësimore, të plotësojnë një formular për vlerësimin e ecurisë gjatë praktikës dhe të informojnë studentin dhe pedagogun përgjegjës të UMSH për çdo pengesë që mund të jetë hasur gjatë praktikës.</p> <p><i>(Evidenca 19 "Marrëveshjet e bashkëpunimit mes UMSH dhe Institucioneve të tjera". Evidenca 18 "Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit", Tabela 5, Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në kuadrin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë". Evidenca 14 "Udhëzim për përgatitje diplome". Evidenca 39 "Udhëzim për praktikën.")</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i tabelave përbërëse në evidencën 18 dhe sipas raportimit analitik të përbërjes së stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitetit, GVJ konstaton se Institucioni nuk raporton personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore apo projekteve studimore – kërkimore. Pavarësisht kësaj, Institucioni deklaron në RVB për këtë kriter se ka kapacitete njerëzore dhe financiare për të garantuar mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera. GVJ këshillon që në të ardhmen Institucioni të angazhohet në caktimin apo punësimin e stafit ndihmës mësimor shkencor të dedikuar për realizimin e orëve laboratorike.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="600 1245 753 1317">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="759 1245 976 1317">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="983 1245 1200 1317">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1206 1245 1406 1317">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="600 1326 753 1370"></td> <td data-bbox="759 1326 976 1370"></td> <td data-bbox="983 1326 1200 1370"></td> <td data-bbox="1206 1326 1406 1370" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, deklarohet se kriter përmbushet plotësisht pasi Institucioni ka partnerë dhe bashkëpunëtorë, propozimet e të cilëve merren parasysh, por pa dhënë referenca të dobishme që dokumentojnë këto deklarata. Në RVB thjesht raportohet se UMSH informohet mbi nevojat dhe</p>

<p>propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>kërkesat e tregut të punës për kompetenca dhe aftësi që duhet të kenë studentët e programit të studimit. Duke qenë se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ nuk ndeshi evidencë për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit për t'iu përshtatur sa më mirë kërkesave të tregut të punës, pyeti gjatë vizitës në Institucion dhe iu konfirmua nga personeli akademik se në të vërtetë opinionet e tregut të punës për përmirësimin e përmbajtjes së programit përthithen gjatë kontakteve të vazhdueshme me ta.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Edhe për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni, deklarohet se kriteri përmbushet plotësisht pasi Institucioni vazhdimisht angazhon studentët në reflektimin për përmirësimin e programit të studimit, por pa dhënë referenca të dobishme që dokumentojnë këto deklarata.</p> <p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ndeshi në evidencën 26, në pikën C të së cilës vihet re se gjatë punës me focus grupet e studentëve synohej që të merreshin opinionet dhe perceptimet e tyre në lidhje me cilësinë e materialeve dhe përmbajtjes së lëndëve që ata zhvillojnë. Në lidhje me evidencën 25, ku paraqitet një formular tip i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, GVJ gjykon se është shumë e përmbledhur dhe e pamjaftueshme që të përthithë opinione cilësore dhe të detajuara nga studentët dhe gjithashtu ka vend për përmirësim dhe detajim të mëtejshëm çka iu shpreh dhe përfaqësuesve të NJSBC gjatë intervistës me këta të fundit.</p> <p>Për shkak të evidencës së vakët dokumentare në këtë pikë, GVJ pyeti stafin, studentët, dhe GVB gjatë vizitës në Institucion dhe u informua se bëheshin përpjekje për përfshirjen e studentëve dhe marrjen parasysh të opinioneve të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 25 "Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti". Evidenca 26 "Procedura e punës me fokus grupet")</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe mërr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, deklarohet se kriteri përmbushet plotësisht pasi Institucioni, nëpërmjet njësisë përgjegjëse, vazhdimisht mban kontakte me të diplomuarit e mëparshëm të programit të studimit për efekte të përmirësimit të programit të studimit, por përsëri pa dhënë referenca të dobishme që dokumentojnë këto deklarata përveç një linku që tregon një takim të mëparshëm me studentët alumni të programit. GVJ këshillon që Institucioni të bëjë përpjekje më konsistente dhe të verifikueshme në drejtim të përmirësimit të reflektimit të sugjerimeve nga studentët alumni.</p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit</p>	<p>Në këtë pikë gjithashtu mungojnë dokumentat mbështetëse për konfirmimin e përmbushjes ose jo të këtij kriteri dhe RVB shprehet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 38

<p>vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>në mënyrë shumë të përgjithshme dhe të papërcaktuar. Gjatë vizitës në Institucion GVJ kërkoi dokumentacion që të mund të gjykonte për këtë kriter dhe nuk mori përgjigje të kënaqshme nga anëtarët e GVB, ndërsa drejtuesit u përgjigjën që efektet në riorganizim (detajimi i programit të studimit në dy profile), do të realizohej në të ardhmen dhe nuk i referohej në fakt periudhës për të cilën Institucioni po i nënshtrohej akreditimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.7 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Neni 4 i Rregullores së Programit të Studimit evidenton objektivat formues kryesorë të këtij programi ku një ndër elementet (pika c) është edhe “thellimi i njohurive shkencore në fushën e financës për të mundësuar ndjekjen e zhvillimeve bashkëkohore dhe zbatimin e tyre në institucione publike dhe private”. Këto, dhe elemente të strategjisë së ndërkombëtarizimit të Institucionit dhe strategjisë së zhvillimit të programit garantojnë përcaktimin e objektivave të qartë në kuadrin e kërkimit shkencor.</p> <p><i>(Evidenca 5 “Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Financë Bankë”. Evidenca 7 “Strategjia e Zhvillimit të Programit MScFB”. Evidenca 8 “Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UMSH”.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni nxit veprimtaritë kërkimore të stafit akademik duke pasur parasysh një bashkërendim të sfondit akademik dhe interesave kërkimore të personelit. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, pedagogët konfirmojnë mbështetjen e institucionit në rast të nevojave për paraqitjen e punimeve shkencore në konferenca ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton përpjekje institucionale dhe të njësisë bazë për të përfshirë studentët në projekte dhe aktivitete kërkimore. Tabela 22 në evidencën 18 jep informacion për përfshirjen e studentëve të programit të studimit MScFB: 6 studentë në punime shkencore individuale të pedagogëve, 3 studentë të përfshirë në projekte shkencore në rang departamenti, 65 studentë të përfshirë në projekte shkencore në rang fakulteti. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion stafi akademik konfirmoi përfshirjen e studentëve në studime dhe publikime dhe vetë studentët u shprehën se ata nxiten</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 39

	nga Institucioni për të marrë pjesë në aktivitete si Panairi i Ideve, dhe janë financuar nga Institucioni kur kjo ka qenë e nevojshme. <i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit", Tabela 22 "Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit". Evidenca shitesë 4.1)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	RVB për këtë kriter është jo relevante në deklaratat që bën dhe në referencat që <u>nuk</u> ofron. Për të formuar një opinion në lidhje me këtë kriter, GVJ intervistoi përfaqësues nga zyra e projekteve për të verifikuar sesa ky program fokusohet në hartimin apo zbatimin e politikave studimore dhe shkencore rajonale dhe kombëtare. Nga përfaqësues të kësaj zyre u bë me dije se momentalisht asnjë nga projektet e Institucionit, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit, por që pedagogët dhe studentët e këtij të fundit janë përfitues indirektë të këtyre projekteve.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	RVB për këtë kriter është jo relevante në deklaratat që bën dhe në referencat që <u>nuk</u> ofron. Për të formuar një opinion në lidhje me këtë kriter, GVJ shqyrtoi informacionet financiare të raportuara në evidencën 17 dhe në tabelën 18 të evidencës 18. Këto informacione ishin të pamjaftueshme që të formohej një opinion në lidhje me këtë kriter. Për këtë arsye GVJ gjatë vizitës në Institucion pyeti përfaqësues dhe kërkoi dokumentacion shtesë. U mësua se fondi i buxhetit për kërkimin shkencor deri më tani administrohet në nivel institucional dhe së shpejti institucioni planifikon të nisë alokimin e këtij fondi në nivel njësie bazë. <i>(Evidenca 17 "Të dhëna financiare Institucionale". Evidenca 18 "Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit", Tabela 18 "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit".)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave	RVB për këtë kriter nuk ofron referenca të dobishme dhe as në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, GVJ nuk gjen materiale mbështetëse. Formalisht, bashkëpunimi mes njësisve institucionale për realizimin dhe arritjen e objektivave të programit të studimit është i

<p>të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>garantuar në Statutin e UMSH si edhe në Rregulloren e FSHE dhe të Programit të Studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 3 "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Evidenca 5 "Rregullore e Programit të Studimit MScFB".)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë riter referohet organizimi i disa takimeve shkencore si leksione të hapura, ëëbinare, etj, dhe gjithmonë pa referencat përkatëse. Pyetur gjatë vizitës në Institucion, GVJ u bë me dije se njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit është i angazhuar në projekte kërkimore në tërësi për Institucionin.</p> <p>GVJ gjithashtu konstatoi se personeli trajnohet për kërkimin shkencor (evidenca 15) me qëllim që të jetë i përgatitur për t'iu përgjigjur thirrjeve të ndryshme dhe përfaqësues të lartë drejtues në Institucion u shprehën se stafi akademik nxitet vazhdimisht të angazhohet në aplikime për projekte të ndryshme.</p> <p><i>(Evidenca 15 "Programi i Trajnimeve 2020 – 2021")</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Për këtë kriter RVB rendit një sërë aktivitete të organizuara nga UMSH për të cilat GVJ pyeti edhe gjatë vizitës në Institucion, por edhe i konfirmoi në faqen e internetit të Institucionit sipas linqeve të mëposhtme:</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/d/136/konference-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-efektet-ekonomiko-sociale-te-saj-ne-nivel-global-dhe-ne-shqiperi-fare-do-te-ndodhe</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/d/93/zhvillohet-konferenca-shkencoreinovacioni-matemaikta-dhe-teknologjia-e-informacionit</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/d/38/anketa-globale-ne-universitetin-mesdhetar-pas-10-vitesh-shqiperia-ben-hapa-perpara-per-akses-in-e-publikut-mbi-buxhetin</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/d/40/starton-puna-per-pergatitjen-e-strategjise-se-re-per-punesimim-per-vitet-2018-2022</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/d/58/umsh-organizon-konferencen-zhvillimii-qendrushem-dhe-politikat-e-punesimit-ne-shqiperi</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Nga shqyrtimi Evidencave të depozituara nga IAL nuk rezulton të këtë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Pavarësisht kësaj, IAL ka hartuar udhëzuesin mbi përdorimin e platformave të mësimi online (<i>Evidenca 34</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Meqënëse RVB nuk shprehte shumë për këtë kriter, gjatë vizitës në vend u pyetën strukturat përgjegjëse (Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, etj) për mekanizmat që kanë zhvilluar për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik në këtë program Studimi. Strukturat drejtuese krahas evidencës së vetme të depozituar më herët që i përkiste një plani pune të gjithë FSHE-së dhe vetëm për vitin akademik 2020-2021, me evidencat shtesë të kërkuara pas vizitës sollën edhe për vitet e tjera akademike. Ata shprehën se kjo kryhet në nivel institucional nga NJSBC, ndërsa në nivel të njësisë kryesore në koordinim mes Dekanatit dhe Departamentit që mbulon programin bazuar në procedurat e parashikuara në aktet rregullative të tyre si edhe planit të monitorimit (<i>Evidenca 12. Plan pune i FSHE për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021. Evidenca 33, Manuali i NJSBCZHK</i>).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	IAL kryen periodikisht vlerësimin e mësimdhënies duke përdorur: <ul style="list-style-type: none"> • Formularin e Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti, • Fokusgrupet me studentë kryesisht lidhur me shfrytëzimin e orës së mësimi dhe cilësinë në shpjegim nga pedagogët. • Takimet e drejtuesve të njësisë kryesore dhe bazë me studentët. • Tërheqja e mendimit të këshillit studentor. • Pyetësorët mbi probleme specifike. <p><i>Përsa më sipër nga RVB citohet vetëm (Evidenca 25.) "Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti"</i></p> <p>Gjatë vizitës drejtuesit e IAL u shprehën se kemi procedura si kryhet ankimimi, por në këto 3 vjet nuk ka pasur asnjë praktikë ankimimi nga studentët.</p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë	Sipas RVB strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit nëpërmjet raporteve vjetore të NJSBCZHK duke e bazuar në Evidencën 21. Raport

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 43

në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë NJSBCZHK. Sipas verifikimit të bërë nga GVJ konstatohet se edhe ky raport i cituar nga GVB i përket vetëm një viti akademik nuk përmban rezultatet e vlerësimit, si edhe nuk gjendet reference në RVB se ku është publikuar në website të UMSH për të siguruar transparencë.</p> <p><i>(Evidencën 21. Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë NJSBCZHK)</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	<p>IAL bazuar në RVB të dhënat nga monitorimet në procesin mësimor, rezultatet nga pyetësorët, rastet pozitive të evidentuara nga komunikimi me studentët i bëhen të ditura në nivel departamenti, për të shërbyer si shembull për gjithë personelin akademik.</p> <p>GVJ konstaton se nuk është e mjaftueshme vetëm kaq, por do të ishte me shumë interes që institucioni të programojë politika dhe ndërmarr masa konkrete për nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në këtë program Studimi aplikohen format e mësimdhënies, të tilla si: leksionet, seminarët, ushtrime/laborator, praktikë profesionale dhe diploma. Staf i akademik përpiqet të organizojë orën mësimore në mënyrë interaktive dhe me situata konkrete biznesi përmes eksperiencave të tyre të punës por edhe të ftuarve nga bizneset apo institucionet publike. <i>(Tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit" në Evidencën 18. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB". https://ëëë.facebook.com/mesdhetari/photos/pb.97556308448.-2207520000../10159155312503449/?type=3&theater)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në	Bazuar në RVB evidentohet se metodat e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e këtij programi janë harmonizuar me zhvillimit të leksioneve në auditor si formë klasike e mësimdhënies dhe metoda të tjera si p.sh, konsultimet e vazhdueshme, plotësimi i kërkesave specifike gjatë sezonit të provimeve, organizimi i diskutimeve dhe debateve me studentët, trajtimi dhe zhvillimi i cikleve të leksioneve të hapura, etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44

<p>përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës u pyetën studentët me aftësi ndryshe (apo diverse) nëse aplikohen të tilla teknika dhe ata konfirmuan se aplikohen. (Evidenca 20. Rregullore për studentët me aftësi ndryshe.)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>IAL ka kujdes në trajnimin e personelit akademik përmes aktiviteteve të përshtatura sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të tyre të tilla si: metodika e mësimdhënies, njohja e kuadrit rregullator, trajnimi i pedagogëve të rinj për aspektin metodik dhe organizimin e procesit mësimor. (Evidenca 15. Programi i trajnimeve 2020-2021; si edhe https://ëëë.umsh.edu.al/d/180/trajnohet-stafi-i-umsh; https://ëëë.umsh.edu.al/c/62/leksionet-e-hapura.)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Sipas bazës së të dhënve të depozituara nga IAL në AMS rezulton se për këtë program studimi ka personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe disa prej tyre edhe të aplikuar në pozicione të ndryshme në fushat e ekonomisë duke mundësuar dhënien e njohurive aplikative dhe stimulimin e mësimnxënies aktive. Metodatat e përdorura për mësimdhënien janë kombinim i mënyrës tradicionale me inovativen në varësi të lëndëve dhe specifikave të programit. (Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB, Tabela 6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e Studimit)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>IAL përmes NJSBCZHK dhe DFBK mbledhin opinione dhe sugjerime lidhur me cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët e lëndëve në programin MSCFB. Metodatat e përdorura janë përmes pyetësorëve, focus grupeve të studentëve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata. Sipas RVB, rezultatet e monitorimit pasqyrohen në raporte me gjetjet përkatëse dhe i përcillen rektoratit me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij procesi në të ardhmen, por në RVB nuk shprehet konkretisht se çfarë është bërë në këto vite për adresimin e gjetjeve nga mendimet dhe sugjerimet e studentëve. Gjatë vizitës u pyetën studentët dhe NJSBCZHK nëse kanë dijeni për ndonjë ndryshim të sugjeruar prej studentëve në këto 3 vitet e fundit dhe ata u shprehën se nuk kishin dhënë ndonjë sugjerim. U kërkuan nga IAL të na dërgojë evidenca të përmirësimeve konkrete të ndodhura në këto tre vjet. U kërkuan të verifikohen disa formularë të plotësuar prej studentëve. Sugjerohet mundësia e rishikimit të formularit (Evidenca 25 “Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti”) për t’u përmirësuar pasi është shumë bazik, por pasi të jetë kryer një studim me pretendentët (stakeholders të tillë si studentët, alumni, punëdhënës bashkëpunëtorë, pedagogët, etj). Vlerësojmë si interesante (Evidencën 26” Procedura e punës me fokus grupet”) por që duhet të azhurnohet edhe për vitet</p>




	<p>akademike 2019-2020 si edhe 2020-2021, pasi evidenca e prezantuar nga IAL i përket vitit akademik 2018-2019.</p> <p><i>(Evidenca 26. Procedura e punës me fokus grupet. Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës u pyetën studentët për metodat interaktive që përdoren nga pedagogët gjatë orëve të mësimit dhe ata cituan përdorimin e shembujve konkretë nga realiteti shqiptar, video prezantime, grupe pune, etj.</p> <p>Sipas RVB por edhe çfarë studentët na konfirmuan gjatë vizitës në IAL, në këtë program studimi aplikohen metoda interaktive duke u përpjekur të tërhiqet vëmendja e studentëve përmes pyetje-përgjigjeve të ndërsjellta, si edhe formave të tjera, si raste studimi, detyra kursi, punë të pavarura, etj. Gjithashtu, studentët evidentojnë si interesante edhe përdorimin e materiale audiovizuale gjatë orës së mësimit për të nxitur analizën kritike dhe pjesëmarrjen aktive.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Përfshirja në aktivitete ku inkurajohet sensi i autonomisë së studentit referuar Tabelës 22 (në Evidencën 18), konstatohet se është i ulët. Gjatë vizitës u kërkua nga drejtues të IAL dhe GVB evidenca për mbështetjen dhe vlerësimin e këtij kriteri dhe në vijim ata sollën evidence për bashkëpunime në projekte shkencore, punime mes studentëve të këtij masteri Shkencor dhe pedagogëve dhe bashkëpunime në artikuj, etj. <i>(Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB për Tabelën 22. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit. Evidenca shtesë 4.1; 5.1; 8.1.)</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Gjatë vizitës në vend u verifikuan ambjentet ku zhvillohet ky program mësimor. Evidentojmë se programi realizohet në ambiente me hapësirë të mjaftueshme rreth 5.1 m² për student si dhe infrastrukturë e përshtatshme për këtë qëllim të pajisur me internet, 3 laboratorë informatike (për studentët e FSHE), 2 laboratorë për lëndët (për studentët e FSHE), kondicionim qëndror, ambjente të pastra, etj. Këto</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>ambjente përdoren edhe për programe të tjera por të alternuara sipas një orari të mirëorganizuar. Sallat përmbajnë pajisjet dhe mjetet e nevojshme (banka, tabela, kompjuter me akses në internet, dhe video-projektor). Gjithashtu, gjatë vizitës u verifikuan edhe zyrat e stafit akademik dhe atij mbështetës dhe u konstatuan se pavarësisht sipërfaqes së vogël, ato ishin të pajisura me PC/laptopë, dhe fisibilitetin e nevojshëm duke garantuar kushte optimale për procesin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore të tyre. Krahas sa më sipër dhe në vijim që do të trajtohen kriteret lidhur me ambientet e UMSH, mund të evidentojmë se gjatë vizitës në IAL, nga drejtuesit e saj na u bë me dije planet afatshkurtra të tyre për zgjerimin me ambjente të reja në objekte shtesë në funksion të programeve mësimore të afuara nga kjo IAL.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>(Tabela 16; Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB. Evidenca 27. Relacioni i Verifikimit të Godinës)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në vend u verifikuan ambientet e bibliotekës dhe konstatohet se ka një hapësirë relativisht të kufizuar (sipas Evidencës 18, tabela ve 157 m²), për numrin e konsiderueshëm të studentëve dhe personelin akademik të kësaj IAL-je. Salla e bibliotekës ishte e pajisura me poste leximi e studimi dhe PC me shërbim interneti për t'ju mundësuar studentëve plotësimin e detyrimeve akademike dhe punën kërkimore.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Sipas GVB literatura bazë dhe literature shtesë gjendet lehtësisht në bibliotekën e institucionit në formë fizike dhe elektronike, në numër titujsh dhe numër kopjesh në përputhje me nevojat e studentëve për këtë program Studimi. Nga GVB citohet se biblioteka elektronike online Questia (www.questia.com) dhe revista "The Economist" kanë një diapason literature prej miliona titujsh.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në procedurat për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me tituj të rinj, për çdo fillim simestri njësisia bazë bazuar në kërkesën e stafit akademik kërkon blerjen e titujve.</p> <p>Referuar RVB-së si edhe tabelat e vendosura në dispozicion evidentohet se në bibliotekë ka rreth 4240 tituj librash (17800 kopje) si literaturë në funksion të programeve të studimit të ofruara sipas fakulteteve. Gjatë vizitës u kërkua prej IAL të sjellin evidenca sa janë titujt dhe kopjet vetëm për fushën e finances dhe bankingut që ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit. Nga evidenca shtesë rezultojnë 351 tituj për nivelin bachelor për programin e studimit për Financë, Bankë dhe Kontabilitet, si edhe 51 tituj për programin e studimit në MSCFB. (Tabela 16; Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë dhe Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat</p>

	<i>on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online në Evidenca 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB. https://ëëë.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press. Evidencë shtesë 21.1)</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	IAL ka siguruar klasa të pajisura me PC dhe lidhje me internet në funksion të cilësisë së mësimdhënies që kërkojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe punës për detyrat e kursit apo punime të tjera akademike. Këto laboratore janë të hapura sipas orareve të publikuara për studentët e programit të studimit MSCFB.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Bazuar në RVB, IAL përmes faqes zyrtare të UMSH në portalin e Studenti mundësohet akses online në të gjithë literaturën e vënë në dispozicion nga pedagogët në funksion të programit mësimor. Nga GVJ u kërkua dhe u krye verifikimi në këtë portal në faqen e UMSH. Gjatë ketyre semestrave të fundit për efekt të mësimin në distance, përdorimi i këtyre platformave ka mbizotëruar në punën e pedagogëve dhe të studentëve, sidomos me platformën google (classroom, google drive, google docs, zoom meetings). Këshillojmë që IAL mund të përzgjedhë vetëm një platform të vetme siç kanë vepruar disa IAL të tjera dhe të mos kenë një shpërndarje në disa platforma.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.	IAL ka siguruar në dispozicion të studenteve dhe pedagogëve një sistem komunikimi si edhe një udhëzues, i cili njih përdoruesit me mënyrën e funksionimit të sistemit si dhe shërbimet që ai ofron. Sistemi i aplikuar ndihmon studentin të gjejë informacionet e nevojshme on-line të tilla si: syllabuset, leksionet, detyrat e kursit, rezultatet e provimeve, etj. Gjatë vizitës u pyetën studentët për të verifikuar si & çfarë kryhet në këtë sistem http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi Menaxhimit Uni Mesdhetar) dhe përgjigja e tyre ishte se shikojnë të dhënat, rregjistrojmë provimet, marim notat, etj. (Evidenca 31. Manual përdorimi i SMS per pedagoget)
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	IAL lidhur me këtë kriter ka depozituar disa evidenca të tilla si rregullore e programit të studimit, udhëzimi për përgatitjen e diplomës, temat orientuese dhe fushat e ekspertizës së stafit akademik me tituj dhe grada me qëllim që studentët të kryejnë punimet e diplomave. Pas miratimit të temës dhe udhëheqësit nga njësi bazë, vijon bashkëpunimi mes studentëve dhe pedagogëve udhëheqës deri në perfundim të punimit dhe dorëzimit në Departament. Gjatë vizitës në IAL u pyetën studentët për të verifikuar si dhe çfarë kryejnë për punimin e diplomës. Cilin kanë si udhëheqës aktualisht dhe çfarë teme kanë zgjedhë? A kanë mbështetje nga IAL për kërkimin shkencor të nevojshëm për punimet e diplomës? Përgjigjet e tyre ishin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

	<p>se kanë nga Pedagogë Udhëheqës vetëm PAE të UMSH, ndërkohë që nuk mund të marrin PAK, pavarësisht se ata janë me tituj dhe me shumë eksperiencë të aplikuara. Studentët propozojnë temën dhe emrat e 3 pedagogëve ndërkohë që Departamenti ju përcakton më pas cilin PAE do të kenë si udhëheqës. Konstatuam se kishte tema jashtë fushës së tyre të studimit të cilat ju përshtateshin PAE nga departamentet e tjera por jo fushës së Studimit të studentëve në këto programe studimi. (Evidenca 5. Rregullore e programit MSCFB, Kreu VI, Neni 24; Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje Diplome; Evidenca 40. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese.)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>NJSBCZHK është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në UMSH dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien (neni 84 i statutit të UMSH dhe neni 28 i rregullores së UMSH). Kjo njësi në koordinim me FSHE dhe DFBK programon veprimet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit. Gjetjet në përfundim raportohen në strukturat përkatëse me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së pedagogëve, njësive bazë dhe gjithë institucionit. (Evidenca 1. Statuti i UMSH; Rregullore UMSH)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>FSHE dhe DFBK bazuar në nenin 18 të rregullores së organizimit të UMSH ndjekin në vijimësi dhe janë përgjegjës për nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik për këtë program studimi. Rezultatet e monitorimit të kryera nga njësia kryesore, njësia bazë dhe NJSBCZHK reflektohen në vlerësimet vjetore për punën e pedagogut me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së tyre në të ardhmen. (Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH. Evidenca 12. Plan pune i FSHE për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021.)</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Njësi bazë nxit zhvillimin e metodave të reja mësimdhënies nëpërmjet zhvillimit të metodave të reja inovative si përdorimi i materialeve</p>




<p>dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>audiovizuale gjatë orës së mësimi, diskutimet e rasteve reale me të ftuar nga biznesi të cilat nxisin analizën kritike dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve, si edhe kryerja e punimeve të pavarura individuale dhe në grup.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar RVB evidentojme se UMSH ka një vëmendje të veçantë për mbështetjen, mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e rritjes së punës shkencore të stafit akademik. IAL ka mbështetur organizimin e konferencave shkencore, Ëëbinare, leksionet e hapura, por edhe stafin akademik për botimin e punimeve të tyre në revistat me faktor impakti.</p> <p>GVJ kërkoi evidenca shtesë nga IAL të disa praktikave të mbështetjes së stafit akademik për botimin e punimeve të tyre në revistat me faktor impakti si edhe pjesëmarrjen në konferenca. Në evidencat shtesë u soll financimi i një praktike pavarësisht se PAE ishte e një departamenti tjetër dhe jo i DFBK, megjithatë ajo çfarë konstatuam është ndjekja e një procesi të formalizuar dhe dokumentacioni respektiv deri në finalizimin e financimit. (Evidenca: https://ëëë.umsh.edu.al/d/136/konference-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-efektet-ekonomiko-sociale-te-saj-ne-nivel-global-dhe-ne-shqiperi-fare-do-te-ndodhe. https://ëëë.umsh.edu.al/d/93/zvillohet-konferenca-shkencoreinovacioni-matemaikta-dhe-teknologjia-e-informacionit. https://ëëë.umsh.edu.al/d/38/anketa-globale-ne-universitetin-mesdhetar-pas-10-vitesh-shqiperia-ben-hapa-perpara-per-aksesin-e-publikut-mbi-buxhetin. https://ëëë.umsh.edu.al/d/40/starton-puna-per-pergatitjen-e-strategjise-se-re-per-punesimim-per-vitet-2018-2022. https://ëëë.umsh.edu.al/d/58/umsh-organizon-konferencen-zhvillimi-i-qendrueshem-dhe-politikat-e-punesimit-ne-shqiperi. Evidenca shtesë 5.1)</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>UMSH tregon një kujdes të vecantë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në aktivitetet e tjera ku personeli angazhohet. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: metodika e mësimdhënies, inovacionet në sektore të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të angazhuar rishtazi, duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të mësimi. Gjithashtu në kuadrin e trajnimeve të planifikuara me angazhimin e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor janë ngritur grupe pune për trajnimin e stafit akademik me synim shtimin e mëtejshëm të njohurive në përdorimin e programeve kompjuterike. Në kuadrin e zhvillimit të njohurive në aplikimin për projekte të ndryshme nga zyra e projekteve</p>

	<p>është mundësuar Trajnimi mbi Programet Europiane për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin.</p> <p><i>Evidenca 15. Programi i trajnimeve 2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Përmes kualifikimeve, trajnimeve dhe motivimit të tyre nga IAL, evidentojmë se stafi akademik dhe personeli ndihmësakademik angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të punës së tyre nëpërmjet rishikimit të syllabuseve, përditësimit të literaturës, përjasjen me metoda inovative në mësimdhënie, si edhe raportimin në vijimësi të rezultateve në strukturat dhe njësitë përgjegjëse me qëllim marrjen e masave të nevojshme.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>FSHE është shumë aktive në organizimin e eventeve ku ftojnë lektorë vendas apo të huaj, kërkues shkencorë, ekspertë vendas apo të huaj në fushën e ekonomisë për të dhënë eksperiencat e tyre mësimore dhe shkencore për studentët dhe pedagogët e këtij fakulteti.</p> <p>Sipas RVB, këto evente i kanë shërbyer edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies apo përdorimit të metodave të reja inovative. <i>(Evidenca: https://ëëë.umsh.edu.al/c/62/leksionet-e-hapura)</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>FSHE është shumë aktive në organizimin e eventeve ku ftojnë lektorë vendas apo të huaj, kërkues shkencorë, ekspertë vendas apo të huaj në fushën e ekonomisë për të dhënë eksperiencat e tyre mësimore dhe shkencore për studentët dhe pedagogët e këtij fakulteti.</p> <p>Sipas RVB, këto evente i kanë shërbyer edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies apo përdorimit të metodave të reja inovative. <i>(Evidenca: https://ëëë.umsh.edu.al/c/62/leksionet-e-hapura)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ bazuar në evidencat e depozituara konstaton se IAL përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve.</p> <p>Të evidentuar në syllabulls gjenden të miratuar metodat e vlerësimit që përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregulloren e programit të studimit. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100 të cilat konvertohen në nota (4-10). Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohen me 10%, plotësimi detyrimeve (detyrave të kursit...) vlerësohen me 20%, testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) me 30% dhe në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 40%, por që përshtaten sipas lëndëve. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik me angazhimin e të gjitha njësive përgjegjëse për programin e studimit dhe në veçanti verbalisht nga personeli akademik dhe ndihmës (sekretari mësimore) dhe në formë të shkruar (rregullore, udhëzues i studentit, syllabus i lëndës).</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe metodat që do të aplikohen për vlerësimin e njohurive, aftësive profesionale dhe dijeve të studentëve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UMSH, Rregulloren e FSHE, Rregulloren e programit të studimit dhe syllabullit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetësuar studentin gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. (Evidenca 5. Rregullore e programit MSCFB, neni 20, 21. Evidenca 38. Udhëzues i studentit. Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021. Evidenca 36. Udhëzues për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës dhe vlerësimi përfundimtar. Këto programe (syllabullit) miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit. (Tabela 15. Format e kontrollit të</p>

	<i>njohurive në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB.)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për zbatimin e këtij kriteri, gjatë vizitës në IAL nga stafi akademik dhe drejtuesit na bënë me dije se deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët pasi sistemi elektronik i përdorur në të kaluarën nuk rezultoi efektiv. Gjatë vizitës u tha se kjo ishte Clean Scoring dhe do ta rritë përsëri pasi të kthehen në auditor. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore. Në kushtet e mësimit online, institucioni ka aplikuar format elektronike (quiz assignment) të testimit dhe vlerësimit të provimeve.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në evidencat e depozituara konstatohet se procedurat dhe afatet e testimit e vlerësimit përfundimtar të njohurive gjenden në kuadrin rregullativ të IAL-së. Sipas RVB-së, teza e provimit përgatitet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me pedagogët e përfshirë në mesimdhënien e lëndës dhe dorëzohet për tu miratuar nga përgjegjësi i departamentit të paktën 2(dy) ditë kalendarike para datës së përcaktuar për provimin përkatës. Komisionet e provimeve janë me nga dy anëtarë, sikurse figurojnë edhe në procesverbalet e provimeve. Ndërsa, anonimiteti i provimit me shkrim ruhet përmes sekretimit të provimit, proces që realizohet nga sekretaria mësimore, sipas përcaktimeve në udhëzuesin e sezonit. Njësia bazë merr masa që në monitorimin e provimit të jenë jo më pak se dy pedagogë dhe procesi të jetë i mbikqyrtë korrektësisht. <i>(Evidenca 35. Udhëzim "Mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimit të dimrit 2019-2020 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve" Evidenca 3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike.pdf. Evidenca 4 Rregullore e Departamentit Financë Bankë Kontabilitet.pdf. Evidenca 5 Rregullore e Programit të studimit MSCFB.pdf)</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë vizitës në IAL u pyeten studentet nëse dhenia e pikeve nga pedagogët shoqërohej me komente/ feedback (nëse ishte i nevojshëm) si edhe dhënien e këshillave mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen, dhe ata i konfirmuan të gjitha këto. Sipas RVB-së, në seancën sqaruese pedagogu këshillon/ sqaron studentin duke i dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm në zgjidhje të problematikave të konstatuara në teza si dhe orienton studentin për përmirësim në të ardhmen duke i ofruar mbështetje të vazhdueshme.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk	Në nenin 49 të rregullores së FSHE parashikohen masat disiplinore në rast konstatimi të plagjiaturës, kopjimit në provime dhe detyra. UMSH ka ngritur Këshillin e Etikës për trajtimin e rasteve të studentëve që mund të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 53

<p>tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>kryejnë veprime të tilla duke aplikuar edhe masa nga vërejtje me gojë deri në përjashtim përgjithmonë nga universiteti, në bazë të shkallës së thyerjes së rregullit të sjelljes.</p> <p>GVJ kërkoi nga GVB të sillen evidenca të rasteve të tilla që janë trajtuar nga Këshilli i Etikës, por ata gjatë vizitës u shprehën se nuk kemi pas asnjë rast. <i>(Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike)</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL u pyet stafi akademik si kryhej sekretimi/çsekretimi. Pyetjeve të GVJ-së ata u përgjigjën se provimet sekretohen nga sekretaria mësimore e cila edhe i ç' sekreton provimet. Sekretaria hedh pikët në sistem dhe pastaj kryhet seanca e këshillimit mes pedagogut dhe studentit. Në përfundim të këtij procesi, notat hidhen nga pedagogët përkatës në sistem.</p> <p>Sipas RVB-së, sekretimi i provimit garanton vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentit. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Studentit, pedagogu rregjistron në procesverbalin analitik (online) pikët për frekuentimin, pikët e provimit të ndërmjetëm/ detyra kursi dhe pikët e provimit përfundimtar, brenda pesë ditëve nga zhvillimi i provimit, pas korrigjimit dhe çsekretimit të tezave.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në nenin 66 të rregullores së FSHE vlerësimi për rezultatin paraprak të provimit iu bëhet i ditur studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale të tyre në kohë reale. Çdo student pasi është njohur me pikët ka të drejtë të marrë pjesë në seancën sqaruese në përfundim të çdo vlerësimi. Kjo seancë afrohet nga komisioni provimit, para hartimit të procesverbalit përfundimtar. Nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, që dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe ndiqet nga njësi bazë përgjegjëse për MSCFB. <i>(Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike)</i>.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL u pyetën studentët nëse kishin raste të ankimit të studentëve për rezultatet e provimeve dhe çfarë kishte rezultuar në përfundim kush kish të drejtë studenti apo komisioni provimit. Ata u përgjigjën se nuk kishin pasur të tilla raste.</p> <p>Sipas RVB-së, "procesi i ankimit përcakton si hap të parë shqyrtimin e ankesës nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit të mëparshëm dhe vendos që teza e studentit të rivlerësohet ose studentit të përsërisë provimin përpara një komisioni të posaçëm. Procesi dokumentohet dhe ruhet sipas udhëzimeve dhe procedurave përkatëse." Gjatë vizitës në IAL u pyet GVB ku e bazon procesin e ankimit të cituar në RVB, por ata nuk e kishin ende të qartë.</p>

	Gjatë trajtimit të shumë kritereve në RVB, nga GVJ u krijua përshtypja se RVB ishte punuar në formë përgjithësuese dhe jo specifikisht për këtë program studimi, prandaj edhe shumë përgjigje nuk ishin shumë të qarta dhe kishte mungesë të evidencave. Ndryshe u paraqit situata gjatë disa prej takimeve në IAL ku GVJ mundi të marrë përgjigje të qarta dhe evidenca shtesë në disa prej takimeve të kryera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit MSCFB bazohet mbi njohuritë e marra në bachelor. Nga vrojtimi i lëndëve vihet re që ka kombinim të mirë të koncepteve në financë që janë marrë në programin bachelor dhe njohuritë shtesë sidomos në fushën bankare. Kjo përjasje e bën të përshtatshëm ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar bachelor për financë. Programi ofron njohuri të përgjithshme në fushën e administrimit, financiar dhe bankar, si edhe rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e auditimit, riskut, marketingut të produkteve bankare, etj.</p> <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale, ky program arrin objektivin e formimit teoriko shkencor të studenteve duke u bazuar në eksperiencat me vlerë të disa prej titullarëve të lëndëve të angazhuar në këtë program mësimor të cilët kanë bërë rishikimet e nevojshme të disa temave në syllabull për të përafër ato me realitetin dhe zhvillimet në tregun financiar dhe bankar në Shqipëri. (Evidenca 7. Strategjia e zhvillimit të programit MSC FB.)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas RVB-së “një nga lëndët e rëndësishme të përfshira në planin mësimor të këtij programi studimi është Sistemet Informatike-Teknologji Bashkëkohore . Konkretisht nëpërmjet kësaj lënde studentëve u ofrohen njohuri të avancuara për mënyrën se si organizatat përdorin teknologjitë dhe sistemet e informacionit për të arritur objektivat e tyre. Sistemet e informacionit përbëjnë një nga mjetet kryesore në dispozicion të menaxhereve të biznesit dhe organizatave të tjera për arritjen e përsosmërisë operacionale, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, përmirësimin e vendimmarrjes dhe arritjen e avantazhit konkurrues.” GVJ nuk konstaton në planin mësimor një lëndë

	<p>të quajtur “Sistemet informatike-Teknologji Bashkëkohore” dhe gjatë vizitës në IAL, GVB nuk ishte ende e qartë.</p> <p>Megjithatë, plani mësimor ka disa lëndë të tjera të cilat në syllabulls të tyre mundësojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e humane komunikimit dhe ndërveprimit. GVJ pyeti GVB se çfarë njohurish dhe si ju mundësohet dhënia e tyre në gjuhë të huaj për të mundësuar aksesin në njohuri nga literature në gjuhë të huaj që citon edhe ky kriter (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). Ata u shprehën se japin literaturë shtesë pothuajse në të gjitha lëndët.</p> <p><i>(Evidenca: Tabela 10. Plani mësimor MSCFB në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB. Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL u evidentua se stafi akademik në orën e fundit të leksionit bashkëbisedon me studentët për realizimin e programit të lëndës (bazuar në syllabusin e lëndës). Gjithashtu, në përfundim të lëndës bëhet analiza e statistikave të sezonit të provimit si edhe rezultatet e nxjerra nga pyetësi i studentëve për çdo pedagog dhe çdo lëndë. Bazuar në analizat e kryera, në fund të çdo viti akademik mund të rezultojë e nevojshme rishikimi periodik i programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në fund të lëndës, pedagogu respektiv (kryesisht lektori) realizon një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim dhe peshën që zë secila prej çështjeve në vlerësimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB-së, gjatë periudhave të ndryshme dhe sipas kontekstit, në auditorët e UMSH janë mbajtur leksione të hapura për studentët për çështje bashkëkohore që prekin jetën e tyre studentore dhe ëëbinare të ndryshme për tema me interes për ata. Në ëëb të IAL-së gjeden disa aktivitete të tilla. Megjithatë GVJ kërkoi nga drejtues të UMSH evidenca lidhur me pedagogët e lëndëve të këtij programi studimi që kanë mbajtur leksione të hapura për studentët për çështje bashkëkohore mbi zhvillimet e reja shkencore. Evidenca shtesë 8.1 radhit të tilla veprimtari të UMSH, ku pjesë e tyre janë edhe disa prej pedagogëve të DFBK të angazhuar në këtë program studimi. <i>(Evidenca shtesë 8.1.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtaura në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapsirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep</p>

	mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët ku ajo është pjesë e planit mësimor por edhe orë laboratorike kur është e nevojshme. Puna në grup ju mundëson studentëve aftësim më të lartë profesional për modelin e të punuarit në ditët e sotme dhe të ardhmen. (Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020-2021)			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nga vizita në IAL dhe takimi me studentet, konstatuam se pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe mbështesin studentët dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore sidomos lidhur me detyrat e kursit dhe temat e diplomave.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	RVB nuk evidenton nëse ka angazhim të studentëve në konferenca Studentore, ku studentët të marrin pjesë me punime shkencore të tyre apo bashkëpunime, të mbështetur nga IAL dhe puna e vazhdueshme e personelit akademik. Pavarësisht se në tabelën 22, tek evidenca 18 jepen disa tregues por mungon narrative për ti evidentuar dhe qartësuar ato. I vetmi organizim është “Panairi i Ideve”, një aktivitet studentor në nivel institucioni. (Evidencë: https://ëëë.umsh.edu.al/d/214/panairi-i-ideve-studentet-prezantojne-iniciativat)			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve	UMSH evidentohet qartë në nivel institucional këto vitet e fundit për ftesën dhe përfshirjen e ekspertëve nga institucione të ndryshme bashkëpunuese vendase apo ndërkombëtare në funksion të punës shkencore dhe asaj mësimore, për të rritur mundësitë e përfshirjes së stafit akademik, studentëve, etj.			
Sākalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVj verifikoi në Website të IAL-së dhe vlerëson publikimin e udhëzuesve të qartë për provimin e diplomimit dhe punimin e diplomes, si edhe ndjekjen me kujdes të procesit të bërjes me dije dhe drejtimin e studentëve që i përmbyllin studimet e tyre me temë diplome apo provimin final. (Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu IX;

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57

	<p>https://eëë.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit https://eëë.umsh.edu.al/media/5ee210c8c94d4.pdf</p> <p>GVJ gjatë vizitës pyeti studentët nëse ka prej tyre që bëjnë provim final dhe jo punim diplome, pasi për këtë kriter GVB është konfuzë dhe ka cituar udhëzimin për provim final. Ndërkohë që në Nenin 24 të <i>Evidencës 5. Rregullore e programit MSCFB</i>, shprehet qartë që diplomimi i studenteve të MSCFB behet vetëm me punim diplome.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>DFBK është struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit. Megjithatë, udhëheqësi mban peshë të rëndësishme pasi zhvillon seanca këshillimore me studentët deri në perfundim të punimit dhe dorëzimit në Departament.</p> <p>GVJ pyeti PAE deri në sa punime diplomash udhëheq një PAE apo PAK. Përgjigje ishte se tema për udhëheqje marrin vetëm PAE deri në 10 tema.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet në Masterin e Shkencave në Financë Bankë</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Nga takimet me studentet dhe stafin, GVJ konstatoi qe udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përzgjedhjen e temës për përgatitjen e punimit të diplomes, duke nisur nga një diskutim i lirë dhe vijuar me hapat e tjerë drejtë finalizimit të temës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL ka vendosur në dispozicion të studentëve bibliotekën dhe labororet e teknologjisë së informacionit me mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera te cilat studentët e këtij program studimi mund t'i perdorin për përgatitjen e temave të diplomave. Por, nga takimi me studentët konstatohet se ata i përdorin shumë pak këto.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL u pyetën PAE dhe PAK si asistonin Studentët në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin dhe shkrimin e tyre sipas udhëzuesve të miratuar. Po kështu u pyetën edhe Studentët sa dhe si ndihmoheshin nga udhëheqësit. Përgjigjet e tyre konfirmonin një bashkëpunim mes tyre.</p> <p>Nga verifikimet dhe vizita në institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës ndihmon në përgatitjen e metodologjisë së studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studenti etj, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit në përputhje me udhëzuesin e miratuar. (<i>Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje Diplome.</i>)</p>

<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës dhe kjo pasqyrohet në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të këtij programi studimi si dhe detyrimeve ndaj institucionit sipas nenit 53 dhe 54 të rregullores së FSHE-së dhe rregullores së organizimit, kontratës së studimit dhe legjislacionit në fuqi studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Këto janë percaktuar dhe miratuar nga MASR. (Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu X, Neni 53, 54. Evidenca 9. Rregullore e sekretarisë mësimore. Evidenca 13. Modeli i diplomës dhe Modeli i Suplementit të Diplomës)</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentëve të programit të studimit MSCFB, iu jepet kopje e plotë e programit të zhvilluar të studimeve pas depozitimit të një kërkesë prej tyre pranë sekretarisë mësimore. Brenda afateve ju jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit. (Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCFB, Kreu VI; Evidenca 9. Rregullore e sekretarisë mësimore.)</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion se dokumentacioni për studentët në vite ishte i plotë dhe verifikoi nëse kish studentë të vitit të kaluar ende të pa matrikular. Në 2019-2020 rezultojnë se janë 34 student të pamatrikular; në 2020-2021 vetëm 17 të pamatrikular. Arsye kryesore që dhanë ishte për studentët me mungesa të dhënash biografike nga Universitetet e Mbyllura (në vitet që do të vijnë këto të dhëna studentët aplikues do t'i marrin nga MASR). Në evidencat shtesë sekretaria dërgoi kopje të shkresave në komunikim me QSHA për adresimin e kësaj mangësie duke treguar kujdesin e tyre për këtë proces. Sipas rregullit, sekretaria u shpreh se pas 4 vjetësh nëse nuk janë plotësuar dosjet, ata janë të detyruar të bëjnë c'rrëgjistrim të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore ka për detyrë të mbajë të dhëna të plota për studentët përgjatë diplomimit dhe pas mbylljes së studimeve dosjet e tyre arkivohen duke respektuar parashikimet ligjore të vendosura nga ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 59

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitet). Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësues, mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ u evidentua ruajtja në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik dhe administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 2 "Rregullore e Organizimit të UMSH", neni 37. Evidenca 5 "Rregullore e Programit të Studimit", nenet 10 & 11.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që u bënë pjesë e DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kërkohet staf akademik me gradën shkencore Doktor, pra një nivel më lart se niveli i studimeve, Master i Shkencave. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të dhënave në RVB.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", nenet 54 – 59. Evidenca 29 "Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit". Evidenca 32 "Kërkesë për staf akademik".)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit. Evidenca 32 dhe edhe disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit në https://ëëë.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-</p>

<p>e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>universitetit-mesdhetar-i-shqiperise. https://www.umsh.edu.al/d/277/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise</p> <p>Cfarë GVJ konstaton është se në nenin 57 të Statuti të UMSH përcaktohen tre kritere për rekrutimin e personelit, më konkretisht, grada shkencore “Doktor”, Vjetërsia në punë prej 5 vite dhe mosha jo më shumë se 68 vjeç. Por në kërkesën për Staf Akademik, evidenca 32, specifikohet si kriter vetëm grada shkencore “Doktor” pa dhënë detaje si vjetërsia në punë dhe mosha jo më shumë se 68 vjeç siç kërkohet në Statutin e UMSH.</p> <p>GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik pa grade shkencore nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ është e mendimit se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin shumë të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 1 “Statuti i UMSH”, neni 57. Evidenca 2 “Rregullore e Organizimit të UMSH”, neni 38 & 39. Evidenca 32 “Kërkesë për staf akademik”.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Sipas verifikimeve të kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton praktikën e ndjekjes së procedurave të rekrutimit të personelit akademik, në përputhje me kriteret e bëra publike. Gjatë vizitës në IAL u kërkua nga BNJ të na vendoset në dispozicion një praktikë punësimi për një PAK dhe një PAE gjatë këtyre 3 viteve të fundit. Procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kritere që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në ëeb faqen e Institucionit por sipas RVB edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngrë një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport</p>

	vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit. <i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", nenet 54 – 59. Evidenca 29 "Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit".)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloheshin nga rrjeti ëireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët. Megjithëse ambientet ishin relativisht të vogla, GVJ u bë me dije gjtë vizitës mbi planet e afërta të Institucionit për t'u zgjeruar me ambiente në të ardhmen e afërt.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë (Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Financë, Bankë), përmenden synime dhe objektiva të mirëfillta të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik. Sipas RVB dhe evidencave (tabelat 19 dhe 20) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit, si edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes Institucionit dhe partnerëve të rëndësishëm akademikë dhe të biznesit, tregojnë se UMSH aktualisht është në drejtimin e duhur për aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore me vlerë. Gjithashtu, nga intervistat me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik, GVJ u informua se përparësi në financim kanë personat që mbrojnë doktoraturën, dhe si lehtësim mund të kenë reduktim oresh, ose edhe financime për pjesëmarrje në konferenca shkencore. <i>(Evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH". Evidenca 7 "Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Financë, Bankë". Referenca nga Tabelat e RVB: Tabela 19 "Kërkimi</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p><i>shkencor i stafit akademik". Tabela 20 "Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit".)</i></p> <p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjësën e Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet, GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe së fundmi edhe në kuadrin e përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies. Bien në sy trajnime për përdorimin e platformës së mësimi online G Suite dhe sistemet "Student Management System". Plani i trajnimeve për stafin akademik hartohet në fillim të vitit akademik dhe të pyetur mbi nivelin e zbatueshmërisë së tij, stafi u shpreh se ishin trajnuar nga Institucioni.</p> <p><i>(Evidenca 15 "Programi i Trajnimeve 2020-2021". Evidenca 34 "Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online".)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 13: "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit") si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Financë, Bankë, Kontabilitetit, i cili është edhe njësisia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Për vitin akademik 2020 – 2021, Departamenti ka 15 personel akademik efektiv, dhe 7 personel akademik me kontratë (të dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2).</p>			
<p>Shtylla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UMSH e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij.</p>

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj.</p> <p>Së fundmi, (maj 2021), godinës së Institucionit i është bërë një vlerësim i pavarur i jashtëm nga një vlerësues i licensuar i pasurive të paluajtshme. Ky akt konstatohet shumë i dobishëm nga ana e GVJ në funksion të garantimit të ofrimit të mjediseve cilësore dhe të sigurt.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit janë në dispozicion 6 salla për leksione dhe 15 salla për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe 3 laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj. Duke qenë se tabela specifikon se këto ambiente i përkasin fakultetit / njësive bazë, gjatë vizitës në institucion u pyet sesi bëhet ndarja e ambienteve sipas nevojave të çdo program studimi që ofron fakulteti / departamentet, dhe përgjigjja lidhej me menaxhimin e programeve të ndryshme sipas orareve të ndryshme. Programi i Studimit Master i Shkencave në Financë Bankë ofrohej kryesisht në oraret e pasdites.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit". Evidenca 27 "Relacion i verifikimit të godinës".)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në UMSH ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti ëireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik.</p> <p>Bazuar në mësimin e zhvilluar gjatë vitit të fundit në platformat online, u konstatua se për këtë program studimi ishin shfrytëzuar G Suite e cila u vlerësua efektive në përdorim nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë janë në dispozicion tre laboratorë informatike (Tabela 16, evidenca 18). Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Cfarë më së shumti përdoret nga studentët e programit Master i Shkencave në Financë Bankë, është programi Qualdrics dhe më pak ai SPSS në funksion të lëndës së Metodave të Kërkimit. Programet e</p>

	kontabilitetit si Financa 5 dhe Alpha Ëeb u konfirmua që përdoren kryesisht nga studentët e nivelit bachelor dhe jo master.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, në evidencën 19, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e UMSH për praktikat dhe cituan si një ndër programet më efektive bashkëpunimin me Raiffesisen Bank, pranë së cilës shumë studentë kishin kryer praktikën profesionale dhe dy prej tyre ishin punësuar.</p> <p><i>(Evidenca 19 "Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera".)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturë e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Sipas verifikimeve të dokumentacionit (tabela 16 në RVB) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se disponon 4 salla për biblioteka. Këto salla, sic u konstatua në vend, në fakt ishin ambiente të përshtatshme për lexim e studim, por bibliotekë e mirëfilltë ishte vetëm një hapësirë kryesore e vetme. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se salla e Bibliotekës ishte e pajisur me ndricim jo natyral, me sistem ngrohje/ftohje, me raftë, 30 poste pune në total, 8 poste me kompjutera, dhe orari i funksionimit ishte 8.30 – 20.00. Sipërfaqja totale e tyre është 157 m2.</p> <p>Kjo sallë është në dispozicion të të gjithë studentëve të Institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 18 "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit". Evidenca 27 "Relacion i verifikimit të godinës".)</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht gjithsej 4.240 tituj librash në rreth 17.800 kopje gjithsej. Tekstet në bibliotekë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 65

<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Meqënëse në DVV nuk u gjetën dokumentacione bazë në lidhje me përmbajtjen e titujve në bibliotekë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi në vend, tituj në bibliotekë të cilët janë të pakët dhe GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në bibliotekën online Questia, ku Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 327.000 tituj librash. Meqënëse në DVV nuk u gjet asnjë dokument bazë për të konstatuar këtë akses, gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi të vihej në dijeni të kontratës me librarinë online, dhe Institucioni siguroi provën e pagesës për aksesin 1 vjetor në Bibliotekë por jo kontratën e kërkuar. GVJ gjithashtu konstatoi në vend se aksesit në bibliotekën online nuk ishte i lehtë për t'u realizuar.</p> <p>Gjithashtu në RVB Institucioni deklaroi se ka dixhitalizuar rreth 17.000 tituj tekstesh mësimore nga fushat e programeve të studimit që ofrohen. Përsëri në DVV nuk gjendet informacion më i detajuar në lidhje me këtë proces dhe GVJ e trajtoi këtë pikë gjatë vizitës në Institucion duke kërkuar të dhëna në lidhje me të drejtën e autorit për dixhitalizimin e teksteve. Institucioni vuri në dispozicion të dhëna të përmbledhura dhe jo të detajuara.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në Internet nëpërmjet rrjetit ëireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të UMSH. Por nga ana tjetër në bibliotekë kishte vetëm 30 poste kompjuterike nga të cilat vetëm 8 me kompjutera. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë. Sugjerojmë shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se UMSH angazhohet në nxitjen e njësive kryesore dhe njësive bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat e tyre për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që secila prej tyre ofron. Një pjesë e tujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të Institucionit.</p> <p>Në DVV, nga ana e GVJ nuk u konstatua asnjë plan konkret apo qoftë edhe model kërkesë për shtimin e titujve të rinj në bibliotekë. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se kërkesat e pedagogeve për tekste të reja mblidhen nga shefi i departamentit i cili ia percjell dekanit dhe ky administratorit.</p>




	<p>Pedagogët u shprehën se kanë mundësi të kenë tekstet e duhura dhe në kohë.</p> <p>Meqënëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument që vërteton ekzistencën dhe për më tepër implementimin e një plani të detajuar të pasurimit të zërave të bibliotekës, sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, duke pasur parasysh edhe sugjerimin më herët në këtë raport për përditësimin me literaturë të 5 viteve të fundit për disa prej lëndëve të programit.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Biblioteka kishte 8 poste pune me kompjuter, dhe 30 poste pune në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 20.00. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Financë Bankë dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>			
<p>Shtalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në DVV se UMSH ka në përdorim dhe shfrytëzon një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me gjeneralitetet dhe ecurinë e studentëve. Sistemi SMS – Student Management System mundëson koordinimin e punës mes stafit akademik dhe atij mbështetës nga njëra anë dhe studentëve nga ana tjetër. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe dhe sic referohet në RVB është funksional</p>

	<p>duke filluar që nga dhjetori 2017. Sistemi ka akses të dedikuar dhe të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Sic u informuam gjatë vizitës në Institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroreshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit. Sistemi SMS përdorej gjerësisht edhe nga ana e stafit administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 31 "Manual përdorimi i SMS për pedagogët". Evidenca 34 "Udhëzues mbi përdorimin e platformave online". http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, SMS është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët dhe jo për aktivitetet e personelit akademik.</p> <p>Në RVB për këtë kriter nuk u gjendën të dhëna të dobishme dhe as referenca që mund të shfrytëzoheshin nga GVJ. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se sistemi SMS nuk administron informacion, dokumentacion apo aktivitete të personelit akademik, ndihmës akademik apo partnerëve. Këto të fundit menaxhohen nga Zyra e BNJ e cila ka një sistem informacioni manual. Në mënyrë elektronike realizohet vetëm procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik, procedurë e cila ishte një nga praktikatat më të mira të vlerësimit të performancës që GVJ dëshmon në IAL.</p> <p>GVJ këshillon që zgjerimi i sistemit aktual SMS ose implementimi i një sistemi tjetër për menaxhimin e të dhënave për personelin do ishte e nevojshme për përmbushjen e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, sistemi SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesi: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët.</p> <p>Nëpërmjet sistemit SMS, stafi akademik mund të realizojë shumë funksione të ofruara nga modulet e ndryshme të sistemit, si psh., modifikojë të dhënat personale në modulën „profili im“, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave dhe të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj.</p> <p><i>(Evidenca 31 "Manual përdorimi i SMS për pedagogët".)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi SMS i UMSH, mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave personale të emailit. Më shumë</p>

informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>informacion në lidhje me sistemin, GVJ mori gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Gjithashtu, sipas evidencës 34, u konstatua se për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor online, gjatë vitit akademik 2020-2021 Institucioni implementoi edhe platformën G Suite me komponentët Google Classroom dhe Google Meet.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua se kjo platformë ishte e llojit: “academic account” duke ofruar facilitate të konsiderueshme për pjesëmarrësit. Megjithatë, GVJ konstatoi se G Suite nuk është e integruar me sistemin SMS, pra ky kriter nuk përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të sstudentëve në UMSH, është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimi nga ana e studentëve dhe e stafit. Kjo referohet në RVB të përgatitur nga institucioni por konstatohet edhe në evidencën 31. Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion sistemi nuk mundëson gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre që kanë të bëjnë me mësimdhënien.</p> <p><i>(Evidenca 31 “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”.)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të universitetit (sipas disa referencave në links më poshtë). GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për shumë prej tyre mungon një bio e shkurtër prezantuese (https://ëëë.umsh.edu.al/c/85/shkenca-ekonomike).</p> <p>Informacionet janë vetëm në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që informacionet në faqen e internetit të publikohen edhe në një gjuhë të BE, për të rritur impaktin e ndërkombëtarizimit të institucionit por edhe për të përmbushur këtë kriter.</p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5ee69d5f5533c.pdf</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/85/shkenca-ekonomike</p> <p>https://www.umsh.edu.al/c/10/aktivitete</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, UMSH përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare (<i>Evidenca 1, "Statuti i UMSH", nenet, 24, 45</i>). Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Institucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit të UMSH dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Evidencë për informacione financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale (<i>evidenca 17</i>), dhe në tabelën 18 në evidencën 18. Vlen të theksohet se informacioni i përfshirë në këto dy evidenca është shumë i përmbledhur në rang institucional dhe në asnjë moment nuk i referohet vetëm programit të studimit në fjalë. Vec kësaj, në asnjë nga këto evidenca nuk u gjetën informacione në lidhje me kostot specifike të programit të studimit; apo informacion për pasurimin e bibliotekës, etj. GVJ kërkoi gjatë vizitës në Institucion një plan financimi dhe mbulimi të kostove për programin e studimit por nuk mori përgjigje të kënaqshme për këtë.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2 "Rregullore e Organizimit të UMSH". Evidenca 17 "Të dhëna financiare institucionale". Evidenca 18 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca 22 "Analizë vjetore e FSHE")</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në RVB të institucionit për këtë kriter, raportohet se pasqyrat financiare të Institucionit i nënshtrohen procesit të auditimit nga audites ligjorë të pavarur dhe plotësohen të gjitha kërkesat e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të</p>	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqërues, pjesë e DVV.</p> <p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni, kontrolli buxhetor realizohet nga Administratori dhe synon të garantojë përdorimin eficient të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 70

<p>financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>burimeve të Universitetit, në funksion të arritjes së objektivave të tij. Sipas DVV, evidencave 1 dhe 2 (neni 23), detyrë e Administratorit është pikërisht ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të çdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare.</p> <p>Në vijim të analizës së shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, nga shqyrtimi i tabelës 18 në evidencën 18, GVJ konfirmon se Institucioni ka paraqitur një plan financiar institucional të krahasuar buxhet kundrejt faktit që nga viti 2017. Por ky plan nuk specifikon ndërhyrjet e posacme apo diversifikimin e financimit të programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë. Elemente të tilla nuk i ndeshëm as në evidencën 22 "Analizë Vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike". Këshillohet që Institucioni të vijojë të punojë për plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2" Rregullore e Organizimit të UMSH". Evidenca 18 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca 22 "Analizë vjetore e FSHE").</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të rrafshueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Në bazë të informacioneve financiare të dhëna në evidencën 17, GVJ konstaton se Institucioni gjatë viteve të fundit rezulton me fitim. Megjithatë nuk jepen informacione më të plota që të lejojnë GVJ të formojë një opinion të plotë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit. Për këtë arsye, gjatë vizitës, GVJ kërkoi raportin e auditimit të pasqurave financiare të cilat, sic shprehet edhe vetë Institucioni në RVB janë përpiluar rregullisht.</p> <p><i>(Evidenca 17 "Të dhëna financiare institucionale")</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 71

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB (evidencat 3, 4 dhe 5), u konstatua se Institucioni ka hartuar politika dhe procedura të plota të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme të ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre në hyrje dhe në dalje, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin e tyre në përfundim të ciklit të studimeve.</p> <p>Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MASR.</p> <p><i>(Referenca nga RVB: Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”. Evidenca 4 “Rregullore e Departamentit Financë, Bankë, Kontabilitet”. Evidenca 5 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë-Bankë”. Evidenca 38 “Udhëzuesi i studentit”. https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet dhe GVB, GVJ u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi i propozohet nga Departamenti.</p> <p>Kandidatët që dëshirojnë të frekuentojnë programin e studimit “Master i Shkencave në Financë, Bankë” duhet të plotësojnë kriteret e renditura në nenin 12 të evidencës 5 “Mbi pranimet e studentëve”, të cilat lidhen me përfundimin e studimeve Bachelor me 180 ECTS pranë një universiteti tjetër publik ose privat shqiptar ose shqipfolës dhe njohja e një prej pesë gjuhëve të BE.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në Financë Bankë mund të pranohen edhe kandidatë pa plotësim kreditesh por nëse kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca ekonomike pranë UMSH, ose ciklin e parë të studimeve në Financë, Bankë, Kontabilitet ose profile të ngjashme pranë një Universiteti tjetër në Shqipëri ose jashtë, gjithmonë në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave. Sipas nenit 12 të Rregullores së Programit të Studimit, pranimi i këtyre studentëve në programin e studimit MScFB i nënshtrohet fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përcaktohen edhe kreditet shtesë që kandidatët duhet të plotësojnë para hyrjes në programin e studimit. Sipas konfirmimeve në Institucion, dekani dhe përgjegjësi i departamentit konfirmuan këtë procedurë.</p>

	<p>Kriter për mesataren nuk ka dhe as për profilin e studimeve të ciklit të parë për ata kandidatë që kanë marrë 180 ECTS. GVJ këshillon përfshirjen e një kriteri për mesataren si edhe profilin në shkencë ekonomike për nivelin Bachelor, duke qenë program studimi i Masterit Shkencor dhe duhet të ketë një nivel të cilësisë në hyrje për kandidatët. Kjo gjithashtu do të garantonte një lloj barazie mes aplikantëve të ndryshëm për sa i përket kontekstit të studimeve të tyre paraprake dhe nivelit akademik të tyre.</p> <p><i>(Referenca nga DVV: Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike” Evidenca 5 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë”).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur, GVJ formoi bindjen se kriteret e pranimit, të përzgjedhjes dhe ecurisë së studentëve përgjatë programit të studimit MScFB janë transparente, pjesë e dokumentacionit zyrtar të Institucionit (si Statuti i UMSH apo Rregullorja e Programit të Studimit), dhe për më tepër janë publikuar edhe faqen e internetit të Institucionit.</p> <p><i>(Referenca nga DVV: Evidenca 1 “Statuti i UMSH”. Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”. Evidenca 5 “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Financë Bankë”.</i> https://ëëë.umsh.edu.al/c/4/studimet. https://ëëë.umsh.edu.al/c/110/bursat)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se Institucioni harton dhe bën publike para çdo viti akademik kritere të vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike (neni 32, pika 2) si edhe një link nga faqja e internetit të Institucionit. Në të vërtetë, linku nuk lidhet me kritere të vecanta sikur kërkohet në këtë kriter. <i>(Referenca nga DVV: Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>GVJ konfirmon se UMSH publikon një sërë udhëzimesh në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Vec kësaj, nga bisedat me përfaqësues të Zyrës e Këshillimit të Studentit dhe Karrierës, u pranua se bëhej një punë e konsiderueshme për informimin e të interesuarve. (https://ëëë.umsh.edu.al/c/46/udhezime)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UMSH. Rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjës të departamentit të DFBK në bashkëpunim me strukturat e tjera organizative të UMSH kur organizojnë javën e parë për çdo vit akademik ku kryhet edhe prezantimi i programit, rregulloreve, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve.</p> <p>Gjithasht, nëpërmjet sekretarisë mësimore, ata informohen për orarin mësimor, frekuentimin, datat e provimeve, të cilat gjenden edhe në faqen online të UMSH si edhe tek shërbimi informacionit në hyrje të UMSH. (Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu III, Neni 14-26 Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCFB, Kreu IV dhe Kreu i V. https://ëëë.umsh.edu.al/c/41/orari-mesimor https://ëëë.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provimet-2020 https://ëëë.umsh.edu.al/c/42/kalendari-akademik https://ëëë.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit dhe të FSHE përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UMSH në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Të gjitha këto ju bëhen me dije studentëve paraprakisht.</p> <p>(Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCFB. https://ëëë.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme Evidenca 38. Udhezuesi i Studentit)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në syllabull të çdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimin, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në çdo lëndë çdo fillim semestri, ditën e parë të javës së parë. (Evidenca 13. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2020- 2021)</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Menaxhimit, dhe të programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësin e departamentit dhe pedagogët udhëheqës të tyre. (Evidenca 5. Rregullore e programit MSCFB; Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje Diplome. Evidenca 40. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese. https://ëëë.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit)</p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>UMSH në fillim të çdo viti akademik organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto informacione përcillen edhe përmes panairove apo medias, si edhe përgatitjes së fletëpalosjes dhe posterave për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Gjithashtu, UMSH ka vendos shumë rol që studentët potencialë mund t'a marrin informacionin për programin e studimit pranë sekretarisë mësimore. (https://ëëë.umsh.edu.al/media/5eb1c1162e146.pdf https://ëëë.umsh.edu.al/media/5eb1bdfe2672f.pdf)</p>		
<p>Udhëzuesi i udhëzuesit të studentëve</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Strandeti V.3 Institucioni duhet të jetë i tërësisht në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshmëritë të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit, në llogarinë individuale të Studentëve në SMS si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqet në faqen e internetit të UMSH, ku kurrikula ngelet për t'u përditësuar.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u confirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës, por edhe një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambientet e institucionit.</p>

	<p>(Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Evidenca 5. Rregullore e programit të studimit MSCFB.</p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/c/41/orari-mesimor https://ëëë.umsh.edu.al/c/73/njoftimi-per-provimet-2020 https://ëëë.umsh.edu.al/c/42/kalendari-akademik https://ëëë.umsh.edu.al/c/43/procesi-i-diplomimit Evidenca 38. Udhezuesi i Studentit)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale, leksioneve të hapura, takimeve dhe informimeve të kryera nga ZKSK. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese, si edhe zhvillimin e aktiviteteve me institucione shtetërore, kompani private dhe me zyrat e punës që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve.</p> <p>(Tabela 23 Mbi punësimin e të diplomuarve në programin MSCFB Programi "Students Direct Sales", punësohen në Bankë part-time 25 studentë të UMSH në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB. https://ëëë.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe chërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambientet e FSHE, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UMSH lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. DFBK mbështetet edhe nga njësitë e tjera ndihmëse si Sekreteria Mësimore, Biblioteka, Zyra Master, SMS, etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UMSH kujdeset për Menaxhimi i Sistemit të Informacionit "SMS" i cili synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Gjatë vizitës në IAL dhe intervistave me stafin akademik por edhe GVB na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin elektronik me studentët.</p> <p>(http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetor)</p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Bazuar në RVB, SMS administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve. Megjithatë, GVJ gjatë vizitës në vend kërkoi dhe verifikoi funksionimin e SMS nëse ky sistem administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.	UMSH mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të FSHE. (Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në Evidencën 18. Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	<p>Sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për çdo vit akademik. Bazuar në të dhënat sipas tabelës 21 në evidencën 18, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none">• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2018-2019 ishte 233 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 6.6;• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2019-2020 ishte 248 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 6.5;• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2020-2021 ishte 155 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 6.7. <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ka një rritje në vitin akademik 2019-2020 por vihet re një rënie e fortë me rreth 93 studentë në vitin akademik 2020-2021 ndërsa rezulton një rritje e lehtë e notës mesatare nga 6.5 në 6.7 (Evidencës 18).</p> <p>Nga komunikimi GVJ me Drejtoren e Programeve Master konstaton se “pavarsisht rënies së numrit të studentëve të regjistruar në vitin e parë përsëri ky program rezulton i kërkuar nga studentët”.</p> <p>(Tabela 21. “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve” në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB”)</p>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit i tyre deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna mbahen dhe përditësohen elektronikisht dhe në hard copy në regjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar).

	<p>Gjatë vizitës në Sekretari Mësimore u kërkuan të verifikohen rregjistrat e studentëve të transferuar në hyrje apo në dalje, si edhe studentët e padiplomuar përsa kohë mund të jenë ende të rregjistruar përtej kufirit të kohës së lejuar (dyfishi i kohës së studimit që do të thotë 4 vjet akademik). Nga sekretaria na u bë me dije se: në vitin akademik 2018-2019 kanë ardhë 16 studentë dhe asnjë nuk është larguar; në 2019-2020 kanë ardhë 9 student dhe asnjë i transferuar; në 2020-2021 kanë ardhë 4 studentë dhe asnjë i transferuar. Gjithashtu na u tha se: nuk kanë ç'rregjistrime sepse ende nuk është plotësuar periudha 4 vjeçare akademike. Në të shkuarën kanë pasë të çrregjistruar të cilët kanë tejkaluar afatin 4 vjeçarë) (Evidenca 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ kërkoi dhe verifikoi me përzgjedhje të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit MSCFB, të cila përfshinin të dhënat personale, numrin e matrikullimit, vlerësimet, nota mesatare në hyrje dhe dalje, etj. Këto të dhëna menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit pranë Sekretarisë Mësimore. (http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Evidenca 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konstaton nga tabela 21 në evidencën 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB”se, IAL ka përpunuar disa të dhëna analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje por jo në dalje të studentëve, si edhe nëse është i punësuar apo jo. Evidentojmë se kaq nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar një raport mbi profilin e studentëve dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, dhe për më tepër që aty mungojnë masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në përfundim GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës të shkëputet nga varësia e NJSBC dhe të dalë si zyrë më vete me qëllim ndjekjen efektive të ecurisë së ALUMNI dhe tërheqjen e mendimeve të tyre në mënyrë të vazhdueshme. (Tabela 21 dhe 23 në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB”)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.5




Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe neni 81, pika c, të Statutit të UMSH institucioni duhet të angazhojë studentë dhe/ose përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH. Sipas RVB-së, studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH. (Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf. Evidenca 37. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor.)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga GVB nuk evidentohet qartë garantimi dhe përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi nga GVB të shprehin si plotësohet ky kriter në UMSH dhe në çfarë strukturash ka përfaqësim nga studentët? GVB konfirmoi se një përfaqësues i studentëve ishte i përfshirë në këtë RVB e cila u shpreh se studentët janë në klubin e studentëve, në këshillin e studentëve ku gjenden senatorët e çdo viti dhe programi, por nuk morëm përgjigje nga askush nëse ata janë pjesë e strukturave vendimmarrëse apo vlerësuese të procesit akademik në këtë program studimi. Edhe studentët e pyetur për këtë kriter nuk kishin informacion më të gjerë sesa u shprehëm më sipër.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi është i mirë hartuar në drejtim të mbajtjes në konsideratë të ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu, referuar statuti të UMSH dhe rregulloreve përkatëse parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme në përputhje me kriteret ligjore në RSH. (Evidenca 5. “Rregullore e Programit të studimit MSCFB”. Tabela 9 në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCFB”)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në UMSH alikohen disa metoda për përfshirjen me qëllim tërheqjen e mendimit të studentëve lidhur më procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përmes formularëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve. • mbledhjet e hapura të Departamentit dhe Këshillit Studentor.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 79

	<ul style="list-style-type: none"> • përmes studentit si përfaqësues në Senat. • përmes studentit si përfaqësues në NJSBC. • përmes fokus grupeve. <p>GVJ kërkoi nga NJSBCZHK disa raste konkrete të ilustruara për çfarë është marrë në konsideratë mendimi i studentëve të këtij programi Studimi. Pergjigja nga drejtuese e NJSBCZHK ishte se nga Studentët nuk ka pasa asnjë pretendim apo sugjerim për përmirësime. GVJ bazuar në këtë përgjigje kupton se kjo njësi nuk arrin të marrë mendimin e lirë të studentëve të cilët janë pretendentët kryesorë në këtë veprimtari. GVJ rekomandon UMSH-së të merren masa për hapjen e NJSBC në drejtim të studentëve, përfshirjen e tyre dhe krijimin e çdo hapësire të mundëshme për tërheqjen e opinionit të tyre lidhur me cilësinë e programit mësimor.</p>								
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Bazuar në disa evidence të paraqitura nga GVB pretendohet se studentëve të këtij programi ju mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë si edhe e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. Evidencat janë statuti i UMSH dhe kuadri rregullator. (<i>Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf. Evidenca 36 Udhezim per provimin e ndermjetem, perfundimtar dhe te sezonit perserites. Evidenca 5. Rregullore e Programit te Studimit MSC FB</i>)</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1048 751 1137">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="751 1048 979 1137">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="979 1048 1203 1137">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1203 1048 1449 1137">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1137 751 1209"></td> <td data-bbox="751 1137 979 1209"></td> <td data-bbox="979 1137 1203 1209" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1203 1137 1449 1209"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vlerëson me konsideratë të lartë stafin akademik me kontratë dhe ata efektiv dhe si rrjedhim edhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare. Gjithashtu, vet UMSH raporton se vlereson periodikisht si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor nivelin e kërkimit Shkencor të stafit akademik.</p> <p>GVJ kërkoi nga IAL të depozitonte një raport konkret me rezultatet e arritura të stafit akademik të angazhuar në këtë program Studimi dhe jo thjesht formularin e raportimit (evidenca 23 e quajtur “Raport i Vetevlerësimit”) që ishte depozituar me RVB-në.</p>




<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>GVJ evidenton angazhime konkrete në drejtim të lidhjes nga UMSH të marrëveshjeve me institucione të huaja të arsimit të lartë, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Konkretisht ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunimi me rrjetet universitare EMUNI dhe EURAS për unifikimin e lëndëve të veçanta të kurrikulës për programet e studimit. • Pjesëmarrja në projekte që financohen nga BE, me kontribut në hartimin e kurrikulave të reja dhe përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, etj. <p><i>(Evidenca 19. Marrëveshjet e Bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera.</i></p> <p>https://ëëë.umsh.edu.al/c/56/aktivitete-2019 https://ëëë.umsh.edu.al/c/60/projektet https://ëëë.umsh.edu.al/c/113/nderkombetarizimi</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>RVB nuk ka evidence të qarta lidhur me këtë kriter pasi ashtu si edhe më herët në këtë RVJ nuk evidentohet angazhimi i personelit akademik në nxitjen dhe bashkëpunimin me studentët e këtij programi për hartimin, shkrimin dhe publikimin e studimeve e punimeve shkencore pavarësisht se në RVB citohet panairi i ideve dhe disa të dhëna në tabelën 22 të evidencës 18.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar të dhënave në tabelën 19 të evidencës 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCFB” konstatohet se stafi akademik i FSHE (nuk ka specifikim vetëm për stafin akademik të angazhuar me këtë program Studimi) ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në konferenca shkencore dhe botime artikujsh Shkencor.</p> <p>GVJ kërkon të njihet nga IAL (Administratori ose NJSBC) se çfarë politika motivuese ka aplikuar UMSH në mbështetjen dhe nxitjen e stafit akademik përveç se ndjek ecurinë e tyre duke bërë vlerësim pikësor në sistemin e vlerësimit të punës së tyre shkencore. Nga IAL pas vizitës na u dërguan evidence shtesë (trajtuar edhe në një kriter më herët në këtë RVJ) ku ilustron rasti i mbështetjes së financimit për veprimtari të cilat shoqërohen edhe me kosto financiare për tarifën e pjesëmarrjes apo publikimit. <i>(Tabela 19 në Evidencën 18. “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCFB”. Evidenca shtesë 5.1.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetnin</p>	<p>Ka përpjekje të mira të stafit akademik por edhe të UMSH për të motivuar studentët të angazhohen në studime inovative dhe Start-up, kjo</p>

studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	realizohet ne auditor dhe veçanërsht UMSH është përpjekur përmes grupeve të punës dhe ëebinars. https://ëëë.umsh.edu.al/c/133/ëebinare		
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Bazuar në udhëzimin për përgatitjen e diplomës, për këtë program Studimi janë të përcaktuara gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë, ditët dhe orët në dispozicion ku çdo pedagog i DFBK që ka student nën udhëheqje të asistojë ata për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomes. Sipas GVB, pedagogu udhëheqës mban regjistër të veçantë për mbarëvajtjen dhe ecurinë javë pas javë të punimit për studentët në ngarkim deri në përfundim të diplomes. (Evidenca 14. Udhëzim për përgatitje diplome)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Bazuar në evidencën 19 “Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera” konstatojmë se UMSH është investuar në krijimin e një rrjeti të gjerë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. Programi i studimit MSCFB e ka shumë të nevojshme konkretizimin e veprimtarive me këto organizma pasi është një program shkencor studimi ku studentët duhet të kenë mundësi të thellimit të njohurive dhe mobilitetit të tyre edhe të këta partner. (Evidenca 19. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis UMSH dhe Universiteteve e Institucioneve të tjera.)
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	GVB në këtë kriter nuk ka dhënë argumenta konkrete megjithatë nëse do ti referohemi përsëri të dhënave në tabelën 19 të evidencës 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCFB” ku konstatojmë se stafi akademik i FSHE ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në konferenca shkencore dhe botime artikujsh Shkencor në disa raste edhe me factor impakti dhe të indeksuara. Kjo përbën një referencë të mirë për të pretenduar se ky staf akademik do të sigurojë vijueshmëri në përgatitjen e studentëve për ciklin e tretë të studimeve dhe sidomos për studentët e MSC FB.

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Për këtë kriter GVJ nuk gjeti referenca në RVB.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Në RVB konstatohet se UMSH mirëpret partneritete në projekte të përbashkëta, lektorë të huaj të ftuar për të pasuruar programet mesimore dhe teknikat e mësimdhënies bazuar në strategjinë për zhvillim dhe ndërkombëtarizim të tij. Për këtë kriter GVJ nuk gjeti në RVB asnjë evidencë konkrete në drejtim të zbatimit të strategjisë. <i>(Evidenca 8. Strategjia e Nderkombëtarizimit të UMSH)</i>			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	GVB në këtë kriter nuk ka dhënë referenca nga kuadri rregullator i UMSH se ku bazohet politika favorizuese e UMSH për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Për këtë kriter GVJ nuk gjeti narrativën e përshtatshme në RVB por edhe referenca e cituar nuk ishte e vlefshme në website të UMSH pasi në pjesët konkrete i referohej personelit akademik vendas dhe jo pedagogëve dhe studentëve të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ eidenton se në UMSH nuk ka një njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore (Zakonisht ato quhen Zyra/Njësia për Këshillimin e Karrierës). Referuar RVB-së, UMSH disponon SMS e cila garanton informimin e studentëve por përsëri nuk është e qartë nëse ka një zyrë me staf të dedikuar të cilët mund të asistojnë përtej informimit që bën sistemi.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Gjithashtu nga GVB është eidentuar se UMSH jep informacion për zhvillimin e praktikës profesionale, punësimin e studentëve, apo vetëpunësimin e tyre duke organizuar seminare për gjetjen dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 83

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>zhvillimin e ideve të reja të biznesit dhe financimin e start-up-ve. Si edhe punësim të studentëve MSCFB brenda UMSH dhe ruajtjen e marrëdhënieve të ngushta me ALUMNI duke e konsideruar si një nga asetet më të vyera në arritjen e objektivave të UMSH.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL u pyet GVB për udhëzimet e studentëve dhe ata u shprehën se kujdeset Zyra e Karrierës por edhe Koordinatori i programit të studimit, Sekretaria Mesimore dhe Departamenti. Gjithashtu prej tyre u kërkuan disa praktika konkrete të punësimit të ish studentëve të këtij programi në UMSH si edhe përgatitja e raporteve me analiza të detajuara të punësimit dhe progresit të tyre.</p> <p>(Evidenca: https://ëëë.umsh.edu.al/d/264/programi-students-direct-sales-punesohen-ne-banke-part-time-25-studente-te-umsh https://ëëë.umsh.edu.al/d/44/memorandumi-studentet-e-umsh-trajtime-dhe-keshillim-karriere-nga-the-headhunter https://ëëë.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private https://ëëë.umsh.edu.al/d/127/alumni https://ëëë.umsh.edu.al/c/133/ëëbinare</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 84

<p>e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe komunikimit me drejtues të IAL gjatë vizitës në IAL, konstatojmë se UMSH në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 ka ngritur strukturën e NJSBC dhe Zhvillimit të Karrierës referuar Nenit 53 dhe 84 të Statutit të UMSH dhe nenit 28 të Rregullores së Përgjithshme që nga Janari 2011 në strukturën organizative të institucionit. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me NJSBCZHK, nga GVJ u bënë disa Pyetje lidhur me detyrat e NJSBC të cilat janë të përcaktuar në kuadrin ligjor e rregullator si edhe në statutin e UMSH, por konstatojmë se NJSBC nuk i njihte ato.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar Nenit 52 të Statutit të UMSH dhe Nenit 22 të Rregullores së Përgjithshme mund të ketë të ngritur edhe Komisionin e Përhershëm në funksion të sigurimit të cilësisë, por GVJ nuk arrin të kuptoj përmes RVB e cila në këtë standard nuk ka cituar evidenca (vetëm një) dhe bazuar në ato të bënte edhe vlerësimin, por është mjaftuar me komente të përgjithshme. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me NJSBCZHK, nga GVJ u pyet nëse ka Komision të përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në UMSH, përgjigja e drejtueses së NJSBCZHK ishte se UMSH nuk e ka këtë komision.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ rekomandon qw IAL të krijojë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel Institucioni me anëtar nga pretendentët kryesorë, me mandate të qarta dhe raportim në Senatën Akademik të UMSH. Ngritja e këtij komisioni do të shërbej për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UMSH si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit Senatën Akademik i UMSH ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme, Manualin e SBC, Rregulloren e NJSBCZHK, Planin strategjik të zhvillimit të UMSH si edhe Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSCFB të cilat plotësojnë kriteret institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu në RVB nuk ka evidence nëse ka përfshirje të studentëve dhe bashkëpunëtorëve e ekspertëve të jashtëm në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Sipas RVB-së, “NJSBCZHK vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UMSH. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi funksionon duke u bazuar në një planveprim vjetor, të cilin e dorëzon në fillim të çdo viti akademik në Rektorat”.</p>

	<p>GVJ rekomandon që NJSBCZHK të sigurojë përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve e ekspertëve të jashtëm në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf; Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH.pdf; Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK.pdf; Evidenca 33 Manuali i NJSBCZHK.pdf; Evidenca 6 Plani strategjik i zhvillimit të UMSH.pdf; Evidenca 7 Strategjia e Zhvillimit te Programit MSCFB.pdf. Evidenca shitesë 16.1)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	UMSH ka integruar në një njësi Zhvillimin e Kurrikulave si edhe SBC duke menduar që këto dy funksione të koordinohen më së miri në shërbim të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Megjithatë sipas RVB-së, në zbatim të akteve rregullative institucionale përsëri pësha bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të marrë masa organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor (janë cituar edhe disa evidenca), por është anashkaluar evidentimi i përgjegjësive konkrete të NJSBCZHK e cila është Njësia e Posaçme e ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrë dhe rishikur programin e studimit.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Referuar RVB-së, nga GVJ u kërkua të njihet me dosjet e plota vjetore që NJSBCZHK ka depozituar dhe ku mund të evidentojmë për çdo fund viti akademik krahas raporteve ditore, javore, mujore ose semestrale, për procese të ndryshme të planveprimtë edhe raportin përmbledhës të gjithë aktivitetit vjetor si dhe sygjërimet e kësaj njësie për çdo aktivitet të vlerësuar.
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBCZHK për:
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e	a) shpeshhtësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin mbi rezultatet e monitorimeve dhe

<p>marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së stafit akademik.</p> <p>Përgjigja nga NJSBC ishte se përpilohej një raport vjetor, ndërkohë që studentët anketoheshin në përfundim të semestrit para se të bëhet Provimi. Por gjithashtu nga drejtues i NJSBC u bëme me dije se shpeshësia e dhënies së opinionëve të tyre ishte edhe javore pasi ata kontrollonin oraret e hyrje daljes nga klasa të pedagogëve. Kjo ishte një praktikë e pandeshur më parë që NJSBC të merret me këtë element. Gjithashtu, në pyetësor nuk ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ nga studentët, për të cilën sugjerojmë IAL ta marr në konsideratë.</p> <p>Sipas NJSBC, pedagogu njoftohet për rezultatet e arritura dhe nëse ka probleme thërritet nga rektorati.</p> <p>b) Ku gjenden të publikuara dhe çfarë përmban raportet vjetore të NJSBCZHK për 3 vitet e fundit?</p> <p>Sipas NJSBC do të na dërgohet një kopje e tyre pasi ato nuk gjendeshin të publikuara në website të UMSH. Evidenca shtesë 15.1 e dërguar është më shumë një raportim për strukturat drejtuese se çfarë detyrash ka kryer kjo njësi dhe jo një analizë e gjetjeve dhe adresimi i tyre përgjatë procesit të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit ashtu siç e kërkojnë standardet dhe vetë statuti UMSH.</p> <p>c) Çfarë masash janë marr në rast të gjetjes së mospërputhjeve në plotësimin e standardeve të cilësisë sipas manualit? Sipas NJSBC nuk ishin marrë masa por do të kontrollonin dhe nëse do të ishin vendosë masa do të na i dërgonin si evidence. Fakti është që në evidencat shtesë nuk morëm asnjë evidencë tjetër për sa më sipër.</p> <p>Në përfundim, GVJ rekomandon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NJSBCZHK të mbaj evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. • Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të UMSH të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet për përmirësimin në vijim të cilësisë. • IAL të shikojë mundësinë e shtimit të stafit në NJSBCZHK ose të ngarkoj me këtë detyrë vetëm staf administrativ që nuk është i përfshirë edhe në mësimdhënie apo detyra të tjera me qëllim për të ushtruar veprimtarinë e njësisë sipas standardeve të kërkuara.
--	--

	<i>(Evidenca 12. Plan pune i FSHE për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021. Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues. Evidencë shtesë 15.1.)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	UMSH ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase kapitalin aksionar dhe tarifat e studimit nga studentët e tij, etj., dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sipas RVB-së, NJSBCZHK raporton tregues, opinione dhe sugjerime që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata. Lidhur me këto gjatë vizitës në IAL nga NJSBCZHK u kërkuan evidenca të këtyre eksperiencave të aplikuara në UMSH për të vërtetuar ato çfarë janë shkruar nga GVB. Por, GVJ nuk konstatoi në raport të kryhen sondazhe apo intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave që ai aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si sondazhe e intervista me punëdhënës për studentët e këtij programi studimi. <i>(Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues; Evidenca 26. Procedura e punës me fokus grupet.)</i>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB nuk shprehet qartë lidhur me këtë standard, por referuar Evidencave të depozituara në AMS mund të evidentojmë se Senati Akademik i UMSH është siguruar që përmes miratimit të Manualit të SBC dhe Rregullores së Përgjithshme të përfshijë aktorë të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit përmes citimit në nenin 4 dhe 5 të Manualit të SBC ku përcaktohet ngritja e GVB dhe në përbërje të tyre të ketë përfaqësues të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmësakademik apo administrativë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ në Manualin e SBC konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në nenin 2 të tij është përcaktuar përbërja e NJSBC e cila nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar të tillë si studentët, alumni, punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj.
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 89


<p>akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Në nenin 6 të tij është përcaktuar cikli i Vetëvlerësimit të Brendshëm të Cilësisë si rregull një herë në 6 vjet duke ju referuar edhe ligjit të arsimit të lartë, dhe vetëm vlerësime të pjesëshme edhe më shpesh nëse do të jetë e nevojshme. Kjo biesh me frymën e ligjit dhe standardet e monitorimit të cilësisë të cilat janë në përfaqje të metodologjisë me bazë riskun dhe jo me cikël. Në nenin 106 të ligjit të arsimit të lartë citohet: “Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet”, duke shprehur një tavan të sipërm për numrin e viteve maksimale të mundëshme për akreditim nga bordi i ASCAL por aspak për t’u aplikuar kjo si tregues nga strukturat brenda IAL të cilat kanë detyrë dhe përgjegjësi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj dhe çfarë janë reflektuar në realitet nëse ka pasë të tilla takime.</p> <p><i>(Ligji i Arsimit të Lartë 80-2015 i datës 22.07.2015); Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf; Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH.pdf; Evidenca 33 Manuali i SBC;)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sipas statutit dhe Rregullores së përgjithshme të UMSH nuk ishte e qartë nëse ishte detyrim ekzistenca e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit, si organ përgjegjës para Senatit për sigurimin e cilësisë në këtë IAL. Nga GVJ sipas përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit u konstatua se nuk ekziston ky komision në nivel Institucional. Megjithatë sipas NJSBC u saktësua se UMSH nuk e ka këtë lloj komisioni.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar ne RVB, UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar). Tërheqja e mendimit të studentëve në UMSH ka shërbyer për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së pedagogëve dhe sipas GVB në ndonjë rast ka pasë edhe marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndërsa NJSBC nuk na konfirmoi ndonjë gjetje materiale të marrë nga studentët dhe si rrjedhim nuk ka pasë asnjë masë të marrë. Kjo për GVJ do të thotë se ka paqartësi edhe brenda vetë IAL-së lidhur me punën e NJSBC. Sipas RVB konstatohen disa konstatime të konsideruara si problemet më kryesore të cilat kanë qënë të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Si edhe për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve në UMSH është arritur përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, ndërsa në RVB shprehet për publikimin nga UMSH të rezultateve të provimeve (https://ëëë.umsh.edu.al/c/11/njofitime). Ndërsa, GVJ gjatë vlerësimit të RVB si edhe Evidencave të depozituara në AMS nuk konstaton që IAL të ketë plotësuar kërkesën e këtij kriteri duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. 			
	Nuk përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
--	--	--	----------	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë Bankë” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Në këtë program studimi ka disa titullarë lëndësh me kualitet të lartë akademik dhe aplikativ.
2. Ka rishikimet e nevojshme të disa prej syllabulls për ti përafuar ato me realitetin dhe zhvillimet në tregun financiar dhe bankar në Shqipëri.
3. Ka prezencë të evidentuar mediatikisht në forume, konferenca dhe takime të cilat ju mundësojnë studentëve të këtij programi të kenë kontakte, të marrin përgjigje apo shkëmbejnë ide me ekspertë të fushës vendas apo të huaj, pedagogë apo akademik të njohur.
4. Vendodhja e UMSH është një pikë e fortë për shkak të afërsisë me institucionet kryesore në vend dhe mbulohet lehtësisht nga transporti publik.
5. Shumë aktiv në lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve konkrete të IAL me IAL të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.

Pika të dobta:

1. Mungon studimi i tregut i fokusuar në kërkesat dhe nevojat e punëdhënësve të sektorit përkatës.
2. Mungojnë elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj.
3. Ka një ngarkim dhe mbivendosje detyrash administrative për personelin akademik, cka mund të ngarkojë këtë të fundit në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj procesit mësimor.
4. Mungesa e disa lëndëve të rëndësishme për formimin e plotë të profilit të profesionistit të kompletuar në fushën e financës dhe bankës.
5. Gjatë praktikave të punësimit, Institucioni nuk përcakton kritere që lidhen me mesataren e aplikanteve për staf akademik me nivel Master shkencor.
6. Institucioni nuk harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe as plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
7. Kryesisht temat e punimeve të diplomave ju përshtaten PAE dhe kjo sjell tema punime diplomash jashtë fushës së studimit të studentëve të këtij program studimi.
8. Ka mungesë informacioni në përpunimin e të dhënave analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në dalje të studentëve, si edhe pozicionin dhe vijimin e punësimit të saj/tij.
9. GVJ evidenton se në UMSH nuk ka një njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore (Zakonisht ato quhen Zyra/Njësia për Këshillimin e Karrierës).
10. Nuk ka mundur ende përfshirjen e alumni, punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj., në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.




11. Nuk ka evidencë që IAL të ketë siguruar transparencë për publikimin në faqen web të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve.

Rekomandime:

GVJ ka këto rekomandime per institucionin:

1. Këshillohet kryerja e analizës së tregut të punës me fokus specifik në këtë program studimi, dhe me të dhëna që vijnë drejtpërdrejt nga kontaktet me pretendentët dhe në veçanti me punëdhënësit, nevojat që ata kanë dhe sugjerimet që ata japin.
2. Institucioni të konsiderojë një përfshirje më të madhe të elementëve të mësimdhënies në gjuhë të huaj, ndoshta mësimin në një lëndë specifike.
3. Ndarja e ngarkesës akademike dhe asaj administrative.
4. Institucioni të aplikoi kriter për mesataren në hyrje të studentëve përderisa kemi një program studimi master shkencor..
5. Shtimi i disa lëndëve të reja për të formuar në mënyrë më të plotë profilin profesional dhe shkencor të programit të studimit.
6. Punësimi dhe angazhimi i personelit ndihmës akademik.
7. Vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master, për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe cilësor.
8. Sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për pasurimin e titujve në bibliotekë.
9. Implementimi i një sistemi informacioni për menaxhimin e të dhënave për personelin akademik, ndihmës akademik apo partnerëve që të mundësojë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.
10. Informacionet në faqen e internetit të publikohen edhe në një gjuhë të BE.
11. Institucioni duhet të hartojë një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
12. Të sigurohet përzgjedhja e temave të diplomës dhe kryerja e tyre brenda fushës së studimit të studentëve në këtë program studimi duke angazhuar edhe PAK të këtij programi studimi.
13. IAL ti japë pozicionin e duhur Zyrës së Karrierës duke e krijuar si strukturë më vete të shkëputur nga NJSBC me qëllim ndjekjen efektive të ecurisë së ALUMNI dhe tërheqjen e mendimeve të tyre në mënyrë të vazhdueshme.
14. IAL të shikojë mundësinë e shtimit të stafit në NJSBC ose të ngarkojë me këtë detyrë vetëm staf administrativ që nuk është i përfshirë edhe në mësimdhënie apo detyra të tjera me qëllim për të ushtruar veprimtarinë e njesisë sipas standardeve të kërkuara.
15. IAL duhet të sigurohet që NJSBC përfshin alumni, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm të fushës në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me qëllim krijimin e çdo hapësire të mundëshme për tërheqjen e opinionit të tyre lidhur me cilësinë e



- programit mësimor. Me qëllim mundësimin e përfaqësimit të këtyre aktorëve duhet të amendohet edhe manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nenin 2 të tij.
16. Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duhet të amendohet edhe në nenin 6 të tij për të aplikuar metodologjinë me bazë riskun dhe jo me cikël në monitorimin e cilësisë për të qenë në linjë me frymën e ligjit dhe standardet e monitorimit të cilësisë (Në nenin 106 të ligjit të arsimit të lartë citohet: “Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet”, duke shprehur një tavan të sipërm për numrin e viteve maksimale të mundëshme për akreditim nga bordi i ASCAL por aspak për t’u aplikuar ky si tregues nga strukturat brenda IAL të cilat kanë detyrë dhe përgjegjësi për vlerësimin në vijueshmëri dhe pa cikël të cilësisë në programet e studimit apo të vetë institucionit).
 17. Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të UMSH të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet për përmirësimin në vijim të cilësisë.
 18. IAL të kujdeset për publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Finance Bank" of the Higher Education Institution Mediterranean University of Albania

Strengths and affirmations:

1. In this study program there are several titled professors with high academic and applied qualities.
2. The Institution has made the necessary revisions of some of the syllabuses to approximate them with the reality and developments in the financial and banking market in Albania.
3. The Institution has a media evidenced presence in forums, conferences and meetings which enable students of this program to have contacts, receive answers or exchange ideas with local or foreign experts, professors or well-known academics.
4. The location of MUA is a strong point due to its proximity to the main institutions in the capital and is easily covered by public transport.
5. The Institution is very active in concluding concrete agreements and collaborations with other counterpart HEIs inside and outside the country.

Weaknesses:

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 95




1. There is a lack of market research focused on the requirements and needs of employers in the relevant sector.
2. Teaching elements, modules, subjects or the whole program in foreign languages are missing.
3. There is a burden and overlap of administrative tasks for the academic staff, which may burden the latter in fulfilling their obligations to the teaching process.
4. Lack of some important subjects for in the field of finance and banking which are essentials for this study program.
5. During the employment procedures, the Institution does not set criteria related to the average of applicants per academic staff with a Master of Science degree level.
6. The institution does not draft a financial report regarding the study program costs nor a plan for the financial support necessary for the progress of the study program for at least one complete study cycle.
7. Mostly the topics of diploma theses suit the EAS and this produces diploma theses outside the field of study for the students of this study program.
8. There is a lack of information in the processing of periodic analytical data on the profile and quality after graduating, as well as the position and continuation of his / her employment.
9. EEG notes that in MUA there is no special unit in the information and student service in accordance with legal provisions (Usually they are called Office / Career Counseling Unit).
10. The Institution has not yet enabled the inclusion of alumni, employers or external experts in the field, etc., in the Internal Quality Assurance System.
11. There is no evidence that the HEI has provided transparency for the publication on the website of MUA of Reports for the analysis regarding the results of the questionnaires from the student survey.

Recomandations:

EEG has the following recommendations for the institution:

1. It is advisable to conduct labor market analysis with a specific focus on this study program, and with data coming directly from contacts with applicants and in particular with employers, the needs they have and the suggestions they give.
2. The institution should consider a greater inclusion of elements of foreign language teaching, perhaps teaching in a specific course.
3. Separation of academic and administrative workload.
4. The institution should apply an average criteria for the student entrance since we have a scientific master study program..
5. Addition of some new subjects to form a more complete professional and scientific profile of the study program.

6. Employment and engagement of academic support staff.
7. Establishment of the average criterion regarding academic staff applicants with a Bachelor or Master degree, to guarantee the selection of staff with the appropriate level of qualification and quality.
8. It is suggested to draft a detailed annual plan for the enrichment of titles in the library.
9. Implementation of a data management information system for academic staff, academic assistants or partners to enable real-time monitoring of academic and administrative activity and enable individual reporting and real-time data for governing bodies and heads.
10. The information on the website should also be published in an EU language.
11. The institution must prepare a financial report of the costs of the study program and a plan for the financial support necessary for the progress of the study program for at least one complete study cycle.
12. To ensure the selection of diploma topics and their completion within the field of study of students in this study program by engaging CAS of this study program.
13. The HEI should give the right position to the Career Office by creating it as a separate structure separate from the NJSBC in order to effectively follow the progress of ALUMNI and to attract their opinions continuously.
14. The HEI should consider the possibility of adding staff to the NJSBC or to charge with this task only administrative staff that is not involved in teaching or other tasks in order to exercise the activity of the unit according to the required standards.
15. HEIs should ensure that the NJSBC includes alumni, associates and external experts in the field in the Internal Quality Assurance System in order to create any possible space for attracting their opinion regarding the quality of the curriculum. In order to enable the representation of these actors, the Internal Quality Assurance manual should be amended in its article 2.
16. The Internal Quality Assurance Manual should also be amended in its Article 6 to apply the risk-based methodology and not the cycle in quality monitoring to be in line with the spirit of the law and quality monitoring standards (In Article 106 of the Law on Higher Education states: "The validity of any institutional accreditation and related study programs may not last more than 6 years", expressing an upper ceiling for the number of maximum possible years for accreditation by the AB of ASCAL but not at all to be applied as an indicator by the structures within the HEI which have the duty and responsibility for continuous evaluation and without a quality cycle in the study programs or the institution itself).
17. The Academic Senate and the Board of Administration of MUA request an analysis (follow up) of the implementation of tasks or measures to address the findings, shortcomings and recommendations identified by the reports for the subsequent improvement of quality.



18. To take care of the publication the study program evaluation results, respecting the freedom and academic ethics, as well as the legislation on personal data.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 98



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushje	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X